




Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional



2024

RAPORT

mbi gjendjen me financimin
kapital të sigurimit pensional
në vitin 2024

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

Slavko Janevski Nr. 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Tel: (+389-2) 3224 229

www.mapas.mk

Maj 2025

Përkthimi në shqip: Shoqëri për shërbime intelektuale Logo Plus


Përmbajtja

Shkurtesa	3
Fjala hyrëse	4
MAPAS, misioni dhe vizioni	6
1. Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendeve në botë në sferën e pensioneve, me theks në financimin kapital të sigurimit pensional	7
2. Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut	12
2.1 Përshkrimi i sistemit pensional	13
2.2 Roli i sigurimit pensional të financuar nga kapitali në sistemin pensional	14
2.3 Institucionet në sigurimin pensional të financuar nga kapitali	15
3 Ndryshimet dhe plotësimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sigurimin pensional të financuar nga kapitali	19
4 Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale	21
4.1 Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2024	22
4.2 Rezultati financiar i shoqërive pensionale	25
4.3 Kapitali, kapitali themelor dhe mjetet individuale të shoqërive pensionale	26
4.4 Indikatorët	28
5 Informacione për fondet e detyrueshme pensionale	28
5.1 Anëtarësimi në fondet e detyrueshme pensionale	29
5.2 Të dhëna për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale	30
5.3 Transferimi i një anëtar nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër	34
5.4 Kontributet në fondet e detyrueshme pensionale	35
5.4.1. Kompensim për vonësë të transferit të kontributeve	36
5.4.2. Mjetet e kthyera në Fondin SPIRMV	37
5.5 Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve të detyrueshme pensionale	38
5.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe shkalla e rendimentit të fondeve të detyrueshme pensionale	44
5.7 Kompensimet tek fondet e detyrueshme pensionale	50
5.8 Pagesa e pensioneve nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital	52
6 Informacione për fondet vullnetare pensionale	54
6.1 Qëllimi i sigurimit vullnetar pensional me financim kapital	55
6.2 Anëtarësimi në fondet vullnetare pensionale	56
6.3 Transferimi i anëtarit nga njëra llogari në tjetrën në të njëjtin fond ose në një fond tjetër vullnetar pensional	59
6.4 Kontributet në fondet vullnetare pensionale	60
6.5 Investimi dhe struktura e portfolit të fondeve vullnetare pensionale	61
6.6 Mjetet neto, njësia kontabël dhe norma e rendimentit të fondeve vullnetare pensionale	66
6.7 Kompensimet tek fondet vullnetare pensionale	71
6.8 Pagesa e kompensimeve pensionale të sigurimit vullnetar pensional me financim kapital	73
7 Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale	74

Shkurtesa

PBV	<i>Prodhiimi bruto vendor</i>
Shtylla e dytë	<i>Sigurimi pensional i detyruar me financim kapital</i>
VFP	<i>Shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale VFP SHOQËRIA PENSIONALE SHA Shkup</i>
VFPv	<i>Fondi i hapur vullnetar pensional VFP– Shkup</i>
FVP	<i>Fondet vullnetare pensionale</i>
ESHS	<i>Enti Shtetëror i statistikës</i>
BE	<i>Bashkimi Evropian</i>
FDP	<i>Fonde të detyrueshme pensionale</i>
IOPS	<i>Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë (International Organisation of Pension Supervisors)</i>
KB e parë	<i>KB Shoqëria e parë për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup</i>
KBPv	<i>KB Shoqëria e fondit pensional të hapur vullnetar - Shkup</i>
KBPd	<i>KB Shoqëria e fondit pensional të hapur të detyrueshëm - Shkup</i>
MAPAS	<i>Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional</i>
BPRMV	<i>Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut</i>
OECD	<i>Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for economic coopération and developement)</i>
Shtylla e parë	<i>Sigurim mbi bazën e solidaritetit të gjeneratave</i>
SAVA	<i>Shoqëria për administrim të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava Shoqëri Pensionale SH.A Shkup</i>
SAVAv	<i>Fondi pensional vullnetar i hapur Sava Pension Plus</i>
SAVAd	<i>Fondi pensional i detyrueshëm i hapur Fondi Pensional Sava</i>
Shtylla e tretë	<i>Sigurim pensional vullnetar me financim kapital</i>
TRIGLAV	<i>Shoqëria për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Shoqëria PENSIONALE TRIGLAV SH.A SHKUP</i>
TRIGLAVv	<i>Fondi i Hapur Pensional Vullnetar Trigllav – Shkup</i>
TRIGLAVd	<i>Fondi i Hapur i Detyrueshëm Pensional - Shkup</i>
DAP	<i>Drejtoria e të Ardhurave Publike</i>
Fondi SPIMV	<i>Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut</i>

Fjala hyrëse



Të nderuar,

Me përfundimin e vitit 2024, përmbyllën nëntëmbëdhjetë vjet nga funksionimi i sigurimit pensional me financim kapital, me rezultate që mund t'i lexoni në detaje në Raportin mbi gjendjen me financimin kapital të sigurimit pensional në vitin 2024, të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS. Raporti përmban përshkrim të karakteristikave mbi financimin kapital të sigurimit pensional, të dhëna për funksionimin e tij, vlerësim të zbatimit të rregulloreve në fushën e financimit kapital të sigurimit pensional dhe të dhëna të tjera me rëndësi për këtë lloj sigurimi deri në fund të vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, asetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale shënuan rritje prej 20,45% dhe arritën 162,85 miliardë denarë, ndërsa asetet e përgjithshme të fondeve vullnetare pensionale shënuan një rritje më të madhe në krahasim me fondet e detyrueshme, me 21,74%, duke arritur në 4,36 miliardë denarë. Kështu, pjesëmarrja e përgjithshme e fondeve pensionale nga shtylla e dytë dhe e tretë në Prodhimin Bruto Vendor (PBV) u rrit dhe e tejkaloi 17,62% për vitin 2024 (prej të cilave 17,16% i përkisnin fondeve të detyrueshme dhe 0,46% fondeve vullnetare).

Gjatë vitit 2024, në fondet e detyrueshme pensionale janë transferuar kontribute në shumën prej rreth 15,48 miliardë denarë, që përfaqëson rreth 1,63% të PBV-së, ndërsa në fondet pensionale vullnetare janë paguar gjithsej rreth 533,92 milionë denarë, që përfaqëson rreth 0,06% të PBV-së.

Struktura e investimeve të mjeteve pensionale në vitin 2024 nuk dallon shumë në krahasim me vitin 2023. Portofoli investues i fondeve të detyrueshme pensionale në vitin 2024 përbëhet nga investime vendore që përfshijnë letra me vlerë shtetërore (64,93%), depozita (1,68%), aksione (2,02%) dhe pjesëmarrje në fonde investuese (0,43%); si dhe investime të huaja që përfshijnë obligacione shtetërore të huaja (0,90%), obligacione korporative (0,15%), pjesëmarrje në fonde investuese (25,70%) dhe aksione (3,29%). Në strukturën e portofolit investues të fondeve pensionale vullnetare vërehet një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së investimeve të huaja, kryesisht për shkak të rritjes së pjesëmarrjes në obligacionet shtetërore të huaja. Portofoli investues për vitin 2024 përbëhet nga investime vendore që përfshijnë letra me vlerë shtetërore (55,76%), depozita (4,90%), aksione (5,96%) dhe një pjesë shumë të vogël në fonde investuese (1,25%); si dhe investime të huaja që përfshijnë obligacione shtetërore të huaja (2,65%), obligacione korporative (0,16%), pjesëmarrje në fonde investuese (24,12%) dhe aksione (4,45%).

Në lidhje me kthimin e fondeve pensionale, në vitin 2024 është vërejtur një rritje e vogël e kthimit si në shumën nominale, ashtu edhe në atë reale, për periudhën shtatëvjeçare 2018 - 2024, si për fondet e detyrueshme ashtu edhe për fondet vullnetare pensionale.

Megjithatë, rritja e ndryshimit të nivelit të kostonë së jetesës, e llogaritur në nivel vjetor, ndikon ende dukshëm mbi shumën e të ardhurave në vlerën reale edhe në vitin 2024. Në shtyllën e dytë, për periudhën 2018 - 2024 u realizua një kthim mesatar vjetor prej 5,03% në shumë nominale, përkatësisht 0,16% në shumë reale, i llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive kontabël të fondeve të detyrueshme pensionale. Në shtyllën e tretë, për periudhën 2018 - 2024 u realizua një kthim mesatar vjetor prej 5,33% në shumë nominale, përkatësisht 0,44% në shumë reale, i llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive kontabël të fondeve vullnetare pensionale.

Kursimi pensional është investim afatgjatë, kurse MAPAS-i kontribuon dhe do të vazhdojë të kontribuojë në përforcimin e vazhdueshëm të kursimeve individuale nëpërmjet sigurimit të menaxhimit të rreziqeve që i kërcënojnë mjetet, pensionet dhe kompensimet pensionale të anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe

reputacionin e sistemit, duke i reduktuar ato në nivelin më të ulët të mundshëm.

Ne jemi të vetëdijshëm për zhvillimin intensiv dhe aplikimin e teknologjisë që po e transformon me shpejtësi mënyrën e funksionimit të sektorit financiar, duke përfshirë edhe financimin kapital të sigurimit pensional dhe do të fokusohemi në nxitjen dhe mbështetjen e përpjekjeve për përdorimin e teknologjisë për përmirësimin e cilësisë dhe të ofrimit të shërbimeve të shoqërive pensionale, si dhe për transformimin tonë digjital me qëllim thjeshtëzimin dhe përmirësimin e funksionit rregullator dhe mbikëqyrës.

Si institucion rregullator dhe mbikëqyrës, çdo ditë udhëhiqemi nga misioni ynë dhe, ashtu si në vitet e kaluara, do të investojmë burimet tona në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të financimit kapital të sigurimit pensional dhe do të veprojmë brenda kornizave të përcaktuara nga mbikëqyrësit e pensioneve, të cilat janë të njohura, të identifikuara dhe të konfirmuara nga Organizata Ndërkombëtare e Supervizorëve të Pensioneve (IOPS).

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve,

Remzi Bajrami

MAPAS, misioni dhe vizioni

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës i cili është themeluar me qëllim për t'u kujdesur për interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe ta nxisë zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional. Është themeluar në korrik 2002. Ka cilësi të personit juridik me autorizime publike, të përcaktuara me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe me Statutin. Për punën e saj përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

MAPAS-i është përgjegjës për lëshimin, tërheqjen dhe marrjen e lejeve për themelimin e shoqërive pensionale, lejeve për kryerjen e veprimtarisë - menaxhimin e fondeve pensionale dhe lëshimin, tërheqjen dhe heqjen e lejeve për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Ajo kryen mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, si dhe rojtare të pronës dhe menaxherëve të huaj të mjeteve. MAPAS-i, gjithashtu e promovon, organizon dhe inkurajon zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional në RMV, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe zhvillon ndërgjegjësimin e publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, për përfitimet e anëtarësimit në fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar, duke përfshirë qëllimet, parimet dhe përfitimet e pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe për çështje të tjera që lidhen me financimin kapital të sigurimit pensional. MAPAS-i miraton akte në përputhje me ligjet në sferën e financimit kapital të sigurimeve pensionale si dhe udhëzime profesionale, manuale dhe ngjashëm në lidhje me financimin kapital të sigurimit pensional dhe inicion miratim të akteve tjera lidhur me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale të cilat ato i menaxhojnë. MAPAS-i gjithashtu bashkëpunon me institucionet përkatëse në RMV dhe jashtë vendit për të siguruar kontroll efektiv të financimit kapital të sigurimit pensional në RMV.

Me Agjencinë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional menaxhon Këshilli i Ekspertëve, i përbërë nga kryetari i Këshillit dhe katër anëtarë:

Remzi Bajrami - kryetar

Mentor Jakupi - anëtar i angazhuar profesionalisht

Darko Sazdov - anëtar i angazhuar profesionalisht

Borçe Bozhinovski - anëtar i jashtëm

Marina Makenaxhieva - anëtare e jashtme.

Në seancën e mbajtur më 14 maj 2025, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut mori vendim me të cilin Remzi Bajrami zgjidhet si kryetar i Këshillit të ekspertëve. Deri në zgjedhje, kryetari i Këshillit të ekspertëve ishte Maksud Ali.

Misioni i MAPAS-it është që t'i mbrojë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe ta nxisë zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional, për ditë më të sigurt të pensionit.

Vizioni i MAPAS-it është që të dallohet si institucion i pavarur, profesional dhe transparent, i cili e mbron dhe e avancojnë financimin kapital të sigurimit pensional.



1

Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendeve
në botë në sferën e pensioneve, me theks tek
financimi kapital i sigurimit pensional¹

1. Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendeve në botë në sferën e pensioneve, me theks tek financimi kapital i sigurimit pensional ¹

Në vitin 2023, asetet pensionale në nivel botëror i tejkaluan 58,5 milionë USD (56,5 milionë USD në vendet anëtare të OECD-së dhe 2,0 bilionë USD në vendet të cilat nuk janë anëtare në OECD), që paraqet një rritje prej 10% në krahasim me vitin 2022. Vlera e aseteve të fondeve pensionale në disa vende të cilat nuk janë anëtare të OECD-së u rrit më shumë sesa në shumicën e vendeve anëtare të OECD-së. Rritja më e madhe u vërejt në vendet që kohët e fundit kanë futur fonde pensionale të detyrueshme, si Armenia dhe Gjeorgjia.

Zmadhimi i vlerës së aseteve pjesërisht i atribuohet performancës pozitive investuese të fondeve pensionale për shkak të zhvillimeve të favorshme në tregjet e kapitalit. Në vitin 2023, indeksi botëror MSCI u rrit me 20%. Çmimet e aksioneve në nivel global u rritën pasi presionet e inflacionit u ulën dhe investorët prisnin ulje të normave të interesit. Këto zhvillime pozitive në tregjet e kapitalit ndikuan në mënyrë të favorshme te fondet pensionale që investojnë kryesisht në aksione, siç janë fondet pensionale në Letoni, Lituani dhe Poloni.

Rritja e aseteve gjithashtu vjen nga shumatat më të larta të kompensimeve në raport me pagesat e pensioneve, veçanërisht në vendet ku faza e pagesës së pensioneve nuk ka filluar ende ose ka filluar kohët e fundit dhe numri i personave që tërheqin mjete është i vogël. Rritja e punësimit dhe e pagave ndikoi gjithashtu në shtimin e kontributeve pensionale në vitin 2023.


Në vitin 2024, u diskutua gjithashtu për fazën e deakumulimit dhe produktet pensionale dhe opsionet për të siguruarit në periudhën pas pensionimit. Hartuesit e politikave duhet të sigurojnë një kuadër për pagesën e kursimeve pensionale nga fondet me kontribute të përcaktuara, i cili merr parasysh se a janë të përshtatshme opsionet e ofruara për të siguruarit në momentin e pensionimit për nevojat e tyre financiare. Zbutja e rreziqeve financiare në periudhën pas pensionimit është e ndryshme nga ajo gjatë fazës së akumulimit të kursimeve pensionale dhe nuk ekziston një zgjidhje universale që vlen për të gjitha sistemet pensionale dhe profilet individuale. Rreziqet financiare që duhet të zbuten pas pensionimit varen në masë të madhe nga roli i fondeve pensionale me kontribute të përcaktuara në kuadër të sistemit pensional, si dhe nga rrethanat individuale dhe gjendja ekonomike. Dizajnimi i opsioneve për pagesën e pensionit duhet ta marrë parasysh diversitetin e nevojave në periudhën pas pensionimit dhe të mundësojë fleksibilitet të mjaftueshëm për t'u përshtatur me situata të ndryshme.

Sistemet pensionale në botë karakterizohen me struktura të ndryshme si rezultat i gjendjeve të ndryshme socioekonomike dhe demografike në këto shtete, i ndikimit të kulturës së popullit dhe shprehive të tij dhe i perceptimeve të kursimit të pensionit. Kreatorët e politikave i nxitin vendet që të kenë burime të shumëllojshme të të hyrave për pensionim nëpërmjet kombinimit të mënyrave të financimit dhe llogaritjes së pensioneve. Sistemet pensionale publike të financuara nga buxheti dhe financimi kapital i sistemeve private mund të plotësojnë njëra-tjetrën. Ato ofrojnë zgjidhje të ndryshme për përmbushjen e qëllimeve konkurruese të sistemeve pensionale dhe kanë kapacitete të ndryshme për të mbuluar lloje të ndryshme rreziqesh me të cilat përballohen individët gjatë jetës së tyre, para edhe pas pensionimit. Sfida kryesore është se si të kombinohen këto karakteristika të ndryshme në një sistem pensional gjithëpërfshirës, që do të jetë i qëndrueshëm dhe i drejtë sa duhet për të gjitha gjeneratat. Për të arritur qëllimet e sistemeve pensionale – sigurimin në pleqëri, është e nevojshme që sistemi pensional të jetë i pranueshëm nga pikëpamja fiskale në afat të shkurtër, i qëndrueshëm në afat të mesëm, kurse në afat të gjatë të sigurojë pensione të përshtatshme. Përvojat dëshmojnë se nuk ekziston një zgjidhje unike, pra një dizajn i vetëm i sistemit pensional që u përshtatet të gjitha vendeve, pasi shtetet përdorin kombinime të ndryshme elementesh (para së gjithash, në mënyrën dhe parimet e financimit të pensioneve dhe në mënyrën e përlllogaritjes dhe pagesës së tyre), që të ndërtojnë një sistem pensional efektiv, në varësi të karakteristikave të tyre ekonomike dhe sociale. Megjithatë, zakonisht, sistemet pensionale janë të ndërtuara si sisteme me shumë shtylla, me qëllim diversifikimin e rreziqeve të ndryshme që ndikojnë mbi sistemet pensionale. Korniza e një sistemi me shumë shtylla, zakonisht, përbëhet nga një kombinim i tri shtyllave: pensioni bazë (si mbrojtje minimale për të gjithë punonjësit apo personat e moshuar), kursim shtesë i detyrueshëm (ose shtetëror ose privat, i financuar në mënyrë kapitale) dhe kursim shtesë vullnetar (financim kapital privat, që përfshin marrëveshje në forma të ndryshme). Në dekadat e fundit, rreziqet nga plakja e popullsisë dhe nga natyra e ndryshueshme e tregut të punës nxisin spektër të gjerë të reformave në sistemet pensionale, me qëllim të zbutjes së tyre, por me qëllim të njëjtë të fundit – sigurim i një sistemi të qëndrueshëm pensional dhe të ardhura adekuate për të siguruarit pas pensionimit të tyre.

Në bazë të hulumtimeve të realizuara mbi reformat kryesore, të miratuara ose të zbatuara ndër vite, ndërmjet vitit 1995 dhe dhjetorit 2024, në programet bazë të solidaritetit ndërbreznor (pay-as-you-go) si pjesë e sistemeve pensionale, janë ndërmarrë disa ndryshime me qëllim që të zmadhohen stabiliteti financiar dhe fiskal. Një nga reformat është rritja e normave të kontributeve në programet e tyre të solidaritetit ndërbreznor në 86 vende gjithsej (p.sh., Emiratet e Bashkuara Arabe, Spanja dhe Venezuela). Mandej, një reformë tjetër e rëndësishme është rritja e moshës së pensionimit në 68 vende (p.sh., Kroacia, Franca, Rumania,


¹ Burimet e shfrytëzuara: Raporte të OECD-së, IOPS-së, FIAP-së dhe analizave dhe vrojtime personale

Grafiku 1.1. Mjete të përgjithshme pensionale, për vend, 2023. (në % prej PBV)



Suedia, Zvicra, Kina dhe Uruguai). Gjithashtu, një tjetër trend është përshtatja e formulave të pensioneve të premtuara, përkatësisht reduktimi gradual i pensioneve të premtuara ose ndryshime në indeksimin e pensioneve, për të ulur kostot fiskale në 71 vende (p.sh., Kuba, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Iraku). Këto masa shpesh zbatohen njëkohësisht me nxitjen për të qëndruar më gjatë në tregun e punës, që ndikon në rritjen e përfitimeve pensionale. Gjithsesi, janë të rëndësishme edhe përpjekjet për rritjen e mbulimit të popullsisë në sistemin pensional dhe nxitjen e pagesës së rregullt të kontributeve pensionale. Që të sigurohen të ardhura të përshtatshme pas pensionimit, si pjesë e reformave të ndërmarra, është përforcuar dukshëm roli i financimit kapital dhe sigurimi privat pensional, nëpërmjet krijimit të fondeve private pensionale ose nëpërmjet ndërmarrjes së masave konkrete për përmirësimin e funksionimit të tyre.

Grafiku 1.2. Norma nominale dhe reale të kthimit investues (IRR) të mjeteve të pensionit, dhjetor 2022 - dhjetor 2023, në %



² Burimi: OECD, Tregu i pensioneve në fokus, 2023.

Treguesit kryesorë që e reflektojnë rëndësinë e sistemeve pensionale janë mbulimi i popullsisë dhe madhësia e aseteve pensionale në sistemet pensionale. Në vitin 2023, asetet pensionale në nivel botëror i tejkaluan 58,5 bilionë USD (56,5 bilionë USD në vendet anëtare të OECD-së dhe 2,0 bilionë USD në vendet të cilat nuk janë anëtare në OECD), që paraqet një rritje prej 10% në krahasim me vitin 2022. Vlera e aseteve të fondeve pensionale në disa vende të cilat nuk janë anëtare të OECD-së u rrit më shumë sesa në shumicën e vendeve anëtare të OECD-së. Rritja më e madhe u vërejt në vendet që kohët e fundit kanë futur fonde pensionale të detyrueshme, si Armenia dhe Gjeorgjia.

Krahasimi i madhësisë së vlerës së aseteve pensionale private në raport me madhësinë e ekonomisë, e shprehur nëpërmjet Prodhimit Bruto Vendor (PBV), jep një pasqyrë më të mirë mbi rëndësinë relative të segmentit pensional privat në vend.

Pjesëmarrja e aseteve pensionale në PBV-në e përgjithshme për vitin 2023 në disa vende të përzgjedhura është dhënë në Grafiku 1.1.² Madhësia e vlerës së aseteve të sistemeve private pensionale ndryshon nga një vend në tjetrin, gjë që, me shumë gjasë, u atribuohet fillimeve të ndryshme të themelimit të këtyre sistemeve, faktit nëse përfshirja në planin pensional është e detyrueshme apo vullnetare dhe, sigurisht, rezultateve të investimeve. Vendet me vlerat më të larta të aseteve zakonisht janë ato me fonde ose plane pensionale të detyrueshme. Për shembull, në Islandë dhe Zvicër, ku punëdhënësit janë të detyruar t'u ofrojnë plane profesionale pensionale të punësuarve të tyre, planet pensionale zotërojnë asetë në vlerë prej 182% dhe 160% të PBV-së përkatësisht. Në Danimarkë dhe Holandë, ku punëdhënësit janë të detyruar të marrin pjesë në plane pensionale sipas marrëveshjeve në nivel industrie, shumica e aseteve është gjithashtu e lartë në raport me PBV-në. Vendet me plane pensionale vullnetare ose të themeluara më vonë kanë shumica më të vogla të aseteve pensionale, me disa përjashtime të rëndësishme siç është SHBA-ja. Në SHBA, ku të siguruarit kursejnë për pension tashmë prej disa dekadash, asetet pensionale përbëjnë pothuajse 70% të të gjitha aseteve pensionale në vendet anëtare të OECD-së. Në vende të tjera me plane pensionale vullnetare ose të vendosura para pak kohe, si Greqia, Hungaria dhe Turqia, asetet e destinuar për pensionim janë ende të kufizuara.

Zmadhimi i vlerës së aseteve pjesërisht i atribuohet performancës pozitive investuese të fondeve pensionale për shkak të zhvillimeve të favorshme në tregjet e kapitalit. Në vitin 2023, indeksi botëror MSCI u rrit me 20%. Çmimet e aksioneve në nivel global u rritën pasi presionet e inflacionit u ulën dhe investitorët prisnin ulje të normave të interesit. Këto zhvillime pozitive në tregjet e kapitalit ndikuan në mënyrë të favorshme te fondet pensionale që investojnë kryesisht në aksione, siç janë fondet pensionale në Letoni, Lituani dhe Poloni.

Rritja e aseteve gjithashtu vjen nga shumica më të larta të kompensimeve në raport me pagesat e pensioneve, veçanërisht në vendet ku faza e pagesës së pensioneve nuk ka filluar ende ose ka filluar kohët e fundit dhe numri i personave që tërheqin mjete është i vogël. Rritja e punësimit dhe e pagave ndikoi gjithashtu në shtimin e kontributeve pensionale në vitin 2023. Normat e punësimit u përmirësuan moderisht në vendet anëtare të OECD-së dhe globalisht gjatë vitit 2023, me shumë vende që regjistruan nivele historikisht të larta të punësimit. Normat e larta dhe në rritje të punësimit nënkuptojnë që një pjesë më e madhe e popullsisë në moshë pune ka mundësi të përfshihet në fondet pensionale. Rritja reale e pagave, midis tremujorit të parë të vitit 2023 dhe tremujorit të parë të vitit 2024 në vendet anëtare të OECD-së, ishte mesatarisht 3,5%. Rritja e pagave çon në rritje të shumës së kontributeve të paguara në fondet pensionale, kur ato llogariten si përqindje e pagës. Në Australi, rritja e normave të kontributeve shtesë e rriti më tej hyrjen e kontributeve në vitin 2023.

Normat nominale të të hyrave të fondeve pensionale ishin pozitive në pothuajse të gjitha vendet e analizuar dhe në shumicën e rasteve e tejkaluan inflacionin, me një mesatare prej 10%. Megjithatë, vendet që nuk janë anëtare të OECD-së u përballuan me inflacion më të lartë, gjë që çoi në norma reale më të ulëta të të hyrave (mesatarisht 1,5%) në raport me vendet të cilat janë anëtare të OECD-së (4,8%). Në Grafikon 1.2. janë paraqitur normat nominale dhe reale të kthimit të investimeve të fondeve pensionale në dhjetor 2022 – dhjetor 2023, për vende të përzgjedhura anëtare të OECD-së dhe vende të përzgjedhura që nuk janë anëtare të OECD-së.

Performanca investuese e fondeve pensionale në afat të gjatë është më e rëndësishme sesa fitimet apo humbjet afatshkurtra, pasi fondet pensionale janë investitorë afatgjatë. Fluktuacionet në rezultatet e investimeve janë të pashmangshme gjatë gjithë jetës së një portofoli pensional. Fondet pensionale kanë realizuar fitime investuese në afat të gjatë, duke kontribuar në rritjen nominale të mjeteve të dedikuara për pensionim. Fondet e pensionit kanë realizuar norma mesatare nominale pozitive të kthimit në 10, 15 dhe 20 vitet e fundit në të gjitha vendet e studiuar. Normat mesatare nominale të kthimit janë gjithashtu pozitive në pesë vitet e fundit, pavarësisht humbjeve të mëdha investuese në vitin 2022 në disa vende (p.sh. Holanda). Turqia ka normat më të larta mesatare nominale të kthimit gjatë 5, 10 dhe 15 viteve të fundit, kryesisht për shkak të rritjes së madhe të çmimeve të instrumenteve financiare të cilat i zotërojnë fondet e saj pensionale.

Faktorët mjedisorë, socialë dhe të menaxhimit (faktorët ESG) janë çështje kyçe për investimin dhe menaxhimin e rreziqeve të fondeve pensionale, kurse zbatimi i tyre në kuadrot rregullatore të sistemeve pensionale në mbarë botën është relativisht i ri. Faktorët ESG po zhvillohen në mënyrë dinamike dhe kanë ndikime dhe rreziqe të ndryshme në varësi të vendit. Pikërisht për këtë arsye, gjatë viteve të fundit kjo temë ka qenë objekt diskutimi, kurse në vitin 2019, IOPS, në bazë të hulumtimeve dhe analizave, përcaktoi udhëzime për mbikëqyrjen lidhur me integrimin e faktorëve ESG në investime dhe në menaxhimin e rreziqeve të fondeve pensionale. Udhëzimet inkurajojnë mbikëqyrësit që të sigurohen se integrimi i qartë i faktorëve socialë, etikë dhe mjedisorë në procesin e investimeve dhe të menaxhimit të rrezikut është në përputhje me detyrimin fiduciar të menaxherëve dhe propozojnë rritjen e transparencës dhe publikimin e këtyre faktorëve nga ana e menaxherëve të fondeve pensionale. Këto udhëzime nuk janë të detyrueshme dhe shërbejnë si udhërrëfyes për mbikëqyrësit pensionalë. Mbikëqyrësit pensionalë mund t'i

zbatojnë ato në përputhje me strukturën dhe rregulloret e sistemit të tyre pensional. Që nga viti 2021, IOPS ka diskutuar edhe për udhëzime zbatimi që do t'u ndihmojnë mbikëqyrësve anëtarë të IOPS-it në zbatimin e udhëzimeve të mbikëqyrjes për integrimin e faktorëve ESG.

Në vitin 2024, u diskutua gjithashtu për fazën e deakumulimit dhe produktet pensionale dhe opsionet për të siguruarit në periudhën pas pensionimit. Hartuesit e politikave duhet të sigurojnë një kuadër për pagesën e kursimeve pensionale nga fondet me kontribute të përcaktuara, i cili merr parasysh se a janë të përshtatshme opsionet e ofruara për të siguruarit në momentin e pensionimit për nevojat e tyre financiare. Zbutja e rreziqeve financiare në periudhën pas pensionimit është e ndryshme nga ajo gjatë fazës së akumulimit të kursimeve pensionale dhe nuk ekziston një zgjidhje universale që vlen për të gjitha sistemet pensionale dhe profilet individuale. Rreziqet financiare që duhet të zbuten pas pensionimit varen në masë të madhe nga roli i fondeve pensionale me kontribute të përcaktuara në kuadër të sistemit pensional, si dhe nga rrethanat individuale dhe gjendja ekonomike. Dizajnimi i opsioneve për pagesën e pensionit duhet ta marrë parasysh diversitetin e nevojave në periudhën pas pensionimit dhe të mundësojë fleksibilitet të mjaftueshëm për t'u përshtatur me situata të ndryshme. Gjithashtu, kuadri rregullator duhet të shqyrtojë mënyrat për të lehtësuar qasjen në opsionet e pensionit për individët që do të përfitonin më shumë prej tyre, sepse edhe kur ekzistojnë opsione të përshtatshme financiare për pensionimin, individët mund të mos kenë qasje në to për shkak të mungesës së vetëdijes, edukimit dhe kuptimit të mjaftueshëm.

Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut **2**

- Përshkrimi i sistemit pensional **2.1**
- Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin pensional **2.2**
- Institucionet të financimit kapital të sigurimit pensional **2.3**

2. Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sistemi pensional maqedonas përfaqëson sistem të kombinuar prej sigurimit pensional publik, të financuar në mënyrë aktuale dhe private, financim kapital i sigurimit pensional privat. Sigurimi pensional i financuar në mënyrë kapitale bazohet në parimin e kapitalizimit të kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Karakteristikë për këtë sigurim është se mjetet në të menaxhohen në mënyrë private dhe konkurruese nga shoqëritë pensionale. Disa nga karakteristikat e rëndësishme të sigurimit pensional të financuar në mënyrë kapitale janë e drejta e përzgjedhjes personale, e drejta për transferueshmëri të mjeteve, si dhe sigurimi i një shkalle të lartë transparence.

Në RMV, në vitin 2024 ekzistojnë katër shoqëri pensionale, nga të cilat tri menaxhojnë nga një fond të detyrueshëm pensional dhe nga një fond vullnetar pensional dhe një shoqëri pensionale që menaxhon me një fond vullnetar pensional.

2.1 Përshkrimi i sistemit pensional

Sistemi pensional maqedonas është pjesë e sigurimit social të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe ka strukturën në vijim:

- Sigurimi mbi bazën e solidaritetit të gjeneratave (d.m.th. shtylla e parë),
- Finansimi kapital i sigurimit të detyrueshëm pensional (d.m.th. shtylla e dytë),
- Finansimi kapital i sigurimit pensional vullnetar (d.m.th. shtylla e tretë).

Kjo strukturë është rezultat i reformës themelore të sistemit pensional, që është përgatitur shumë vite, ndërsa korniza e saj ligjore është vendosur në vitin 2000. Ekzistojnë katër ligje dhe numër i madh i akteve nënligjore që e rregullojnë sistemin pensional në RMV. Ato janë: Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, Ligji për financimin kapital të sigurimit pensional, Ligji për financimin kapital të sigurimit pensional vullnetar, Ligji për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve të pensionit nga financimi kapital i sigurimit pensional dhe numër më i madh i akteve nënligjore që e përpunojnë në mënyrë shtesë sferën përkatëse.

Sistemi pensional në RMV ka histori të gjatë të ekzistimit shumëvjeçar, mbulim të madh të fuqisë punëtore dhe sigurim të pensioneve për personat e siguruar. Por ndryshimet socioekonomike në RMV, në fillim të viteve të 90-ta, kishin ndikim në sistemin pensional, i cili u përballua me vështirësi financiare në funksionimin e tij. Ato u shkaktuan nga lëvizjet e pafavorshme në ekonomi të cilat ndikuan në uljen e numrit të të siguruarve aktivë dhe uljen e pagesës së kontributeve nga njëra anë dhe rritjen e numrit të pensionistëve nga ana tjetër. Shpenzimet për pensione shënuan rritje të vazhdueshme.

Faktor tjetër që ka ndikim të fuqishëm mbi sistemin pensional është faktori demografik. Përkatësisht, plakja e popullsisë, që është trend botëror, do të thotë se njerëzit jetojnë gjithnjë më gjatë për shkak të kushteve më të mira dhe shërbimeve më të mira shëndetësore, e njëkohësisht zvogëlohet numri i të porsalindurve, përkatësisht të rinjve. Si rezultat i këtij faktori pjesëmarrja e të moshuarve në popullsinë e përgjithshme është gjithnjë më e madhe.

Lëvizjet e këtyre demografike në sistemin pensional shkaktojnë paraqitje të numrit të zmadhuar të pensionistëve dhe shfrytëzim më afatgjatë të pensionit, kurse zvogëlim të numrit të të siguruarve. Për sistem me financim rrjedhës është i rëndësishëm raporti ndërmjet të të siguruarve dhe pensionistëve, sepse me kontributet nga të siguruarit ekzistues paguhen pensionet për pensionistët ekzistues. Projektionet e aktuarit, të përpunuara gjatë përgatitjes së reformës së sistemit pensional, treguan se mund të pritët që këta faktorë të kenë ndikim të madh negativ mbi solvencën e Fondit të SIPMV-së, në afat të gjatë, përkatësisht pa reforma sistemi do të funksionojë me deficit të shprehur që rritet shpejt dhe dukshëm.

Me qëllim përmbushjen e këtyre situatave të pritura, u realizua reformë themelore të sigurimit pensional dhe invalidor në shtetin tonë, me të cilin u fut sistem pensional treshtyllësh, me mënyrë të kombinuar të financimit të pensioneve të ardhshme dhe me diversifikimin e rreziqeve demografike dhe ekonomike, me qëllim sigurimin e pensionit të sigurt për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme të pensionistëve dhe stabilitet financiar afatgjatë të sistemit pensional.

Shtylla e parë financohet në bazë rrjedhëse (PAYG), që do të thotë se me kontributet nga të siguruarit ekzistues paguhen pensionet e pensionistëve të tanishëm. Kjo shtyllë funksionon në parimin e a.q. pensione të definuara, përkatësisht përmes tij sigurohen pensione sipas formulës së paracaktuar për përlllogaritje të pensionit. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, si dhe shuma më e ulët e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë paraqesin financim kapital të sigurimit pensional në të cilin bëhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Këto dy shtylla funksionojnë në parimin e a.q. kontribute të definuara, përkatësisht tek ato, është paracaktuar niveli i kontributit që paguhet, ndërsa pensioni përcaktohet mandej, në varësi nga shuma e akumuluar. Nga shtylla e dytë

paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtja financiare/kompensim gjatë pleqërisë, invaliditetit dhe në rast të vdekjes së të siguruarit.

Me vendosjen e sistemit pensional shumëshpyllës si një sistem i kombinuar i sistemit të sigurimit pensional publik, me financim rrjedhës, privat dhe kapital në RMV, pritet të sigurohet stabilitet afatgjatë i sistemit dhe siguri në realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, nëpërmjet realizimit të përfitimeve afatgjate për individët që marrin pjesë në sistemin pensional për vetë sistemin pensional si dhe efekte shtesë mbi ekonominë. Përkatesisht, në aspekt të personave individuale sigurohet siguri më e madhe në realizimin e pensionit i cili do të financohet nga disa burime, kështu që bëhet ndarja e rreziqeve.

Në të njëjtën kohë, me reformën arrihet transparencë dhe informim më i madh i anëtarëve të fondeve pensionale. Reforma duhet të çojë në vendosjen e sistemit pensional solvent si dhe rritje të kursimeve dhe nxitje të investimit të popullsisë dhe stimulim të rritjes ekonomike.

2.2 Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Financimi kapital i sigurimit pensional dallohet rrënjësisht nga sigurimi i financuar pensional dhe në aspekt të trajtimit dhe evidencës së kontributeve të paguara ashtu edhe në aspekt të përcaktimit dhe pagesës së pensionit. Në këtë sigurim, çdo anëtar ka llogari individuale në të cilën evidentohen pasuritë e tij dhe sigurohet lidhje dhe varësi e ngushtë mes vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do t'i realizojë çdo person. Kjo mënyrë e sigurimit bazohet në parimin e mjeteve të akumuluar të kontributeve të llogarive individuale, të cilat investohen më tej dhe të ardhurat e realizuara nga investimet, të zvogëluara për shpenzimet e punës së sistemit, në tërësi u shtohen mjeteve të grumbulluara në llogaritë individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale dhe nga jetëgjatësia e pritur gjatë pensionimit, përkatesisht periudha e pritur e shfrytëzimit të pensionit. Është e rëndësishme të theksohet se ky kursim pensional është kursim afatgjatë, gjatë të cilit ka ndodhur rritje graduale, por e vazhdueshme e kursimeve, me ç'rast fillimisht, derisa i siguruari është i ri, kursimet janë të vogla, por në të ardhmen, kur i siguruari arrin moshën e pensionit, kursimet bëhen dukshëm më të mëdha.

Karakteristike për këtë sigurim është ajo që mjetet në të menaxhohen në mënyrë private dhe të vazhdueshme, kështu që kontributet e paguara investohen nga ana e shoqërive të licencuara pensionale që menaxhojnë me fondet pensionale. Në këtë mënyrë, sigurohen qëllimet ekonomike për ta caktuar strategjinë investuese, duke krijuar mundësi për maksimizim të të ardhurave të përgjithshme në interes të anëtarëve. Diversifikimi i rreziqeve të investimeve (përfshirë edhe diversifikimin ndërkombëtar) është një prej karakteristikave më të rëndësishme të këtij sistemi.

Gjithashtu, karakteristika të rëndësishme të financimit kapital të sigurimit pensional janë e drejta e zgjedhjes personale dhe iniciativa e individit. Të gjithë të punësuarve, para 1 janar 2003, u dha mundësia për të vendosur nëse do të përfshihen në shtyllën e dytë të sistemit pensional dhe të zgjedhin se në cilin fond të detyrueshëm pensional dëshirojnë të anëtarësohen, ndërsa të gjithë të punësuarit e rinj pas datës 1 janar 2003 kishin mundësinë të zgjedhin fond të detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes së tyre. Gjithashtu me ndryshimet në Ligjin për financimin kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional nga dhjetori 2018, për anëtarët e fondeve të detyrueshme pensionale të cilët vullnetarisht janë anëtarësuar në shtyllën e dytë (të punësuar për herë të parë para datës 1.1.2003) dhe që kanë lindur para datës 1.1.1967, iu dha mundësia të zgjedhin ta ndërpresin ose vazhdojnë anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale. Të gjithë personat e sapopunësuar pas datës 1 janar 2019, të cilët në datën e hyrjes në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor janë nën moshën 40 vjeç, kanë mundësinë të zgjedhin fond të detyrueshëm pensional sipas dëshirës së tyre. Më pas, anëtarësimi në fondet pensionale vullnetare është sipas zgjedhjes personale ose nëpërmjet pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale, të financuar nga punëdhënësi ose nga shoqatë qytetare.

Mbartshmëria (portabiliteti) i mjeteve është, gjithashtu, e drejtë e rëndësishme në një sistem të financimit kapital të sigurimit pensional. Të gjithë anëtarët e fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, kanë të drejtën e kalimit nga njëri fond në tjetrin fond pensional, me ç'rast transferohen edhe mjetet e tyre të kursyera. Dhe në rast të pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale, personi ka të drejtë që gjatë kalimit të sigurosi tjetër t'i transferojë mjetet e kursyera ose në skemë tjetër pensionale profesionale ose në llogarinë individuale vullnetare.

Financimi kapital i sigurimit pensional siguron shkallë të lartë të transparencës që paraqet një prej karakteristikave të tij të rëndësishme dhe risi e dobishme në sistemin pensional. Shoqëritë kanë obligim ligjor, minimum njëherë në vit, t'i informojnë në formë me shkrim anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondit pensional për gjendjen e mjeteve në llogaritë e tyre individuale, me dorëzim të a.q. "zarf i gjelbër", me raport për kursim pensional. Zarf i gjelbër, gjithashtu, përmban të dhëna për investimin e fondit pensional për kompensimet e paguara dhe për të ardhurat e realizuara të fondit pensional.

2.3 Institucionet e financimit kapital të sigurimit pensional

Institucionet që bëjnë pjesë në sistemin pensional me tre shtylla janë:

- Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë – kompetente për krijimin dhe menaxhimin e politikave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe për ushtrimin e kontrollit në zbatimin e legjitimitetit të këtij sigurimi.
- Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS) – institucion rregullator dhe mbikëqyrës në financimin kapital të sigurimit pensional. MAPAS-i paguan kompensim nga shoqëria pensionale që përlogaritet si përqindje e kontributeve të paguara në fondet pensionale. Për vitin 2024, kjo përqindja ishte 0,7% .
- Shoqëria pensionale – shoqëri aksionare e themeluar nga institucionet financiare me kapital dhe përvojë të madhe, aktiviteti i vetëm i së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale. Në sistemin e njohur pensional ka mundësi për themelim të tri llojeve të shoqërive:
 - o Shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme,
 - o Shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare,
 - o Shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare;
- Rojtari i pronës së fondit pensional – i ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional në llogari të veçantë, të veçuara nga mjetet e shoqërisë.
- Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP) – kryen pagesë të centralizuar të kontributeve dhe në Fondin e SPIMV-së i dorëzon kontributet e përgjithshme për sigurim pensional dhe invalidor.
- Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut - kryen shpërndarje të kontributeve për sigurim pensional ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë dhe kryen transferim të kontributeve dhe të dhënave përkatëse për anëtarët, në fondet e zgjedhura të detyrueshme pensionale të shtyllës së dytë. Çdo shoqëri që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional ka për obligim t'i paguajë kompensim mujor Fondit të SIPMV-së në shumë prej 0,1% nga secili kontribut i paguar në muajin paraprak në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon.

Shoqëria pensionale është shoqëri aksionare që themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe Ligjin për financim kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional, ose me Ligjin për financim kapital të sigurimit vullnetar pensional. Shoqëria pensionale themelohet me leje nga MAPAS-i dhe menaxhon me fondin pensional në bazë të lejes për menaxhim me fondin pensional. Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale themelohet dhe menaxhon vetëm me fondet e detyrueshme pensionale, shoqëria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare themelohet dhe menaxhon vetëm me fondet pensionale vullnetare, ndërsa shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare themelohet dhe menaxhon me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe pensionale duhet të ketë kryegjë themelore në lartësi prej së paku 1,8% milionë euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së, shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale duhet të ketë kryegjë themelore prej së paku 1,5 milionë euro dhe shoqëri për menaxhim me fonde pensionale vullnetare duhet të ketë kryegjë themelore prej së paku 0,5 milionë euro. Në rastin e zmadhimit të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe/ ose vullnetar me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar që ta rrisë kryegjë në pajtim me dispozitat ligjore. Veprimtaria e vetme e shoqërisë pensionale është menaxhimi me fondet pensionale, prezantimi i tyre para personave të tretë dhe aktivitetet të cilat dalin drejtpërdrejt nga kryerja e punës së menaxhimit me fondet pensionale. Përgjegjësitë themelore dhe aktivitetet e shoqërisë pensionale janë: anëtarësimi, menaxhimi me mjetet, menaxhimi me rreziqet dhe mekanizmat kontrolluese për zbutjen e rreziqeve, administrata dhe mbajtja e evidencës, respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore, njoftimi i rregullt i anëtarëve, publikut dhe i MAPAS-it, pagesa e tërheqjeve të programuara të anëtarëve të pensionuara, etj. Shoqëria pensionale punon në pajtim me rregullat për menaxhim të mirë korporativ të shoqërisë dhe ka detyrë fudiciare për të punuar vetëm në dobi të interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit pensional me të cilin menaxhon, që duhet ta realizojë duke zbatuar standardet e larta të etikës dhe integritetit dhe pa konflikt interesi. Për kryerjen e këtyre funksioneve, shoqëritë pensionale, në pajtim me ligjin paguajnë tre lloje kompensimi. (Më shumë detaje për kompensimet ka në kapitujt 5.7 dhe 6.7).

Fondi pensional (i detyrueshëm ose vullnetar) përfaqëson fond të hapur investues, që themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për fonde investuese, nëse me Ligjin për financim kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional, ose me Ligjin për financim kapital të sigurimit vullnetar pensional, nuk është përcaktuar më ndryshe. Fondi i detyrueshëm pensional përbëhet nga kontributet dhe mjetet e anëtarëve, mjetet e anëtarëve të pensionuar dhe të ardhurat nga kontributet e investuara, të zvogëluara për kompensimet që paguhen nga fondi i detyrueshëm pensional.

Fondin pensional vullnetar e përbëjnë kontribute vullnetare të paguara në emër dhe për llogari të anëtarëve, mjeteve të anëtarëve,

mjeteve të anëtarëve të pensionuar dhe të ardhurat nga kontributet e investuar dhe mjetet, të zvogëluara për kompensimet që paguhen nga fondi pensional vullnetar. Pronarët e fondit pensional janë anëtarët e tij dhe anëtarët e pensionuar, ndërsa të drejtat e tyre pronësore individuale janë të caktuara nga shuma e mjeteve në llogaritë e tyre. Mjetet e fondit pensional nuk mund të jenë lëndë e kërkesave, as mbi ato mjete nuk mund të kryhet përmbartim nga, ose në emër të kreditorëve të shoqërisë pensionale që menaxhon me atë fond pensional.

Në vitin 2005 MAPAS-i me tender publik ndërkombëtar dha dy leje për themelimin e shoqërive, me çrast u themeluan dy shoqëri për menaxhim me fondet pensionale, kurse në vitin 2009 MAPAS-i dy shoqërive ekzistuese për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale u dha leje për kryerjen e veprimtarisë - menaxhim me fondin pensional vullnetar dhe leje për menaxhim me fondin pensional vullnetar. Gjatë vitit 2017 dhe gjysmës së parë të vitit 2018 u realizua procesi i shitjes së shoqërisë aksionare për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Fondi i ri pensional" Shkup përkatësisht u bë transferimi 100% i aksioneve të emetuara nga NLB Fondi i ri pensional SHA Shkup³ Pozavarovalnica Sava d.d. Lubjana, Republika e Sllovenisë. Në qershor të vitit 2018, MAPAS-i dha leje për ndryshimin e emrit të shoqërisë Shoqëria aksionare për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Fondi i ri pensional" Shkup në Shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava shoqëri pensionale sh.a. Shkup, dha leje për ndryshim të emrit të fondit pensional Fondi i hapur i detyrueshëm pensional - "NLB Fondi pensional"

Shkup në Fond të hapur pensional vullnetar Sava penzija plus dhe dha leje për ndryshim të emrit të fondit pensional Fondi i detyrueshëm i hapur pensional - "NLB Penzija Plus" Shkup në Fondi vullnetar i hapur pensional Sava Penzija Plus. Në vitin 2019 u themelua shoqëria e tretë pensionale. Përkatësisht, në fund të muajit mars 2019, MAPAS-i dha leje për themelimin e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare të Zavarovalnica TRIGLAV DD Lubjana, Republika e Sllovenisë dhe leje për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional dhe leje për menaxhim me fondin pensional vullnetar. Pastaj në vitin 2022 u themelua shoqëria e katërt pensionale. Në fund të muajit maj 2022, MAPAS dha leje për themelimin e shoqërisë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale të Shoqërisë për menaxhim me fondet e hapura dhe të mbyllura investuese VFP FOND MENAXHMENT SHA SHKUP dhe leje për menaxhim me fondin vullnetar pensional.

Përfundimisht me 31.12.2024, në RMV, ekzistojnë tri shoqëri pensionale që menaxhojnë me nga një fond të detyrueshëm pensional dhe me nga një fond pensional vullnetar siç është paraqitur në tabelën 2.1.

Tabela 2.1 Shoqëritë pensionale dhe Fondet pensionale në RMV

Shoqëria për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava Penzisko Drushtvo sh.a. Shkup	KB Shoqëria e parë për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup	Shoqëria për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Triglav Penzisko Drushtvo SH.A Shkup	Shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale SHOQËRIA PENSIONALE VFP SHA Shku
e cila administron me:	e cila administron me:	e cila administron me:	e cila administron me:
- Fondi i hapur i detyrueshëm pensional Sava Penziski Fond - Fondi i hapur vullnetar pensional Sava Penzija Plus	- KB Fondi i parë i hapur i detyrueshëm pensional – Shkup - KB Fondi i parë i hapur vullnetar pensional - Shkup	- Triglav fondi i hapur i detyrueshëm pensional – Shkup - Triglav fondi i hapur vullnetar pensional –Shkup	Fondin e hapur vullnetar pensional VFP - Shkup
Rojtar i pronës së fondeve pensionale: NLB Banka SHA Shkup ³	Rojtar i pronës së fondeve pensionale: Shparkase Banka SHA Shkup	Rojtar i pronës së fondeve pensionale: Banka Komerciale SHA Shkup	Rojtar i pronës së fondeve pensionale: Banka Komerciale SHA Shkup
Aksionar: - Pozavarovalnica Sava d.d., Republika e Sllovenisë - 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.	Aksionarë: - Skupina Prva zavarovalniski holding DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë - 51% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë - Komercijalna Banka SHA Shkup, Republika e Maqedonisë - 49% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë	Aksionar: -Zavarovalnica Triglav DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë - 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.	Aksionar: Shoqëria për menaxhim me fonde të hapura dhe të mbyllura investues VFP FOND MENAXHMENT SHA SHKUP, Republika e Maqedonisë së Veriut - 100% pjesëmarrje në kryegjënë e shoqërisë:
Kapitali themeltar: 2,1 milionë euro.	Kapitali themeltar: 1,8 milionë euro.	Kapitali themeltar: 5,4 milionë euro.	Kapitali themelor: 0,5 milionë euro.

Tabela 2.2. Shumat që i arkëtojnë kujdestarët e pasurisë nga shoqëritë pensionale kompetent për ruajtjen e pasurisë së fondeve pensionale

Për fondet e detyruara pensionale	Shuma (në nivel vjetor	Për shumën e mjeteve (në milionë euro)	Data e zbatimit
Shparkase Makedonija SHA Shkup si rojtar i pronës së KBPd		0,030%	3 tetor, 2022
		0,024%	3 tetor, 2023
NLB Banka SHA Shkup si rojtar i pronës së SAVAd	0,058%	deri 100	4 prill 2019
	0,055%	mbi 100 deri 200	
	0,050%	mbi 200 deri 300	
	0,048%	mbi 300 deri 400	
	0,040%	mbi 400 deri 500	
	0,037%	mbi 500 deri 600	
	0,035%	mbi 600 deri 700	
	0,032%	mbi 700 deri 800	
	0,029%	mbi 800 deri 900	
	0,025%	mbi 900 deri 1000	
	0,024%	mbi 1000	
Banka Komerciale SHA Shkup si rojtar i pronës së TRIGLLAVd	0,050%	deri 50	1 prill 2019
	0,041%	mbi 50 deri 100	
	0,038%	mbi 100 deri 200	
	0,035%	mbi 200 deri 300	
	0,033%	mbi 300 deri 400	
	0,028%	mbi 400 deri 500	
	0,026%	mbi 500 deri 600	
	0,025%	mbi 600 deri 700	
	0,023%	mbi 700 deri 800	
	0,020%	mbi 800 deri 900	
	0,018%	mbi 900 deri 1000	
	0,017%	mbi 1000	

Tabela 2.2. Shumat që i arkëtojnë kujdestarët e pasurisë nga shoqëritë pensionale kompetent për ruajtjen e pasurisë së fondeve pensionale

Fondet pensionale vullnetare	Shuma (në nivel vjetor)	Për vlerën e mjeteve (në milionë euro)	Data e zbatimit
Shparkase Makedonija SHA Shkup si rojtar i pronës së KBPv	0,06%		3 tetor, 2018 deri 3 tetor, 2023
			3 tetor, 2023 deri 2 tetor, 2028
NLB Banka SHA Shkup si rojtar i pronës së SAVAv	0,180%	deri 50	4 prill, 2019
	0,144%	mbi 50	
Banka Komerciale SHA Shkup si rojtar i pronës së TRIGLLAVv	0,050%	deri 50	1 prill, 2019
	0,041%	mbi 50 deri 100	
	0,038%	mbi 100 deri 200	
	0,035%	mbi 200 deri 300	
	0,033%	mbi 300 deri 400	
	0,028%	mbi 400 deri 500	
	0,026%	mbi 500 deri 600	
	0,025%	mbi 600 deri 700	
	0,023%	mbi 700 deri 800	
	0,020%	mbi 800 deri 900	
	0,018%	mbi 900 deri 1000	
	0,017%	mbi 1000	
Shparkase Makedonija SHA Shkup si rojtar i pronës së VFPv	0,050%	deri 50	18 tetor 2022
	0,041%	mbi 50 deri 100	
	0,038%	mbi 100 deri 200	
	0,035%	mbi 200 deri 300	
	0,033%	mbi 300 deri 400	
	0,028%	mbi 400 deri 500	
	0,026%	mbi 500 deri 600	
	0,025%	mbi 600 deri 700	
	0,023%	mbi 700 deri 800	
	0,020%	mbi 800 deri 900	
	0,018%	mbi 900 deri 1000	
	0,017%	mbi 1000	
Banka Komerciale SHA Shkup si rojtar i pronës së VFPv	0,050%	deri 50	8 nëntor, 2023
	0,041%	mbi 50 deri 100	
	0,038%	mbi 100 deri 200	
	0,035%	mbi 200 deri 300	
	0,033%	mbi 300 deri 400	
	0,028%	mbi 400 deri 500	
	0,026%	mbi 500 deri 600	
	0,025%	mbi 600 deri 700	
	0,023%	mbi 700 deri 800	
	0,020%	mbi 800 deri 900	
	0,018%	mbi 900 deri 1000	
	0,017%	mbi 1000	

³ Aksionarë të shoqërisë aksionare për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Fondi i Ri Pensional" Shkup ishin: Nova Ljubljanska Banka, d.d., Ljubljana, Republika e Sllovenisë, e cila morri pjesë me 51% në kryegjënë e shoqërisë dhe NLB Banka SHA Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila morri pjesë me 49% në kryegjënë e shoqërisë.

Ndryshimet dhe plotësimet e akteve
ligjore dhe nënligjore që rregullojnë
financimin kapital të sigurimit pensional

3

Ndryshimet dhe plotësimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë financimin kapital të sigurimit pensional

Në drejtim të përmirësimit dhe të saktësimit ose thjeshtësimit të disa procedurave, në vitin 2024 u miratuan ndryshime në rregulloret të cilat i rregullojnë fushat e punës së agjentëve të shoqërive pensionale dhe vlerësimin e mjeteve të fondeve pensionale. Me këtë rast, u saktësua procedura për dëshmimin e përmbushjes së kushteve nga kandidatët për dhënien e provimit për agjentë, në përputhje me rregullativën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe u lehtësua procesi i vlerësimit nëpërmjet përcaktimit të qartë të përdorimit të çmimeve të publikuara për vlerësimin e pjesëmarrjeve në fondet investuese vendase.

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Ekspertëve të MAPAS-it miratoi djettë rregullore, përkatësisht ndryshime të rregulloreve, të cilat kanë të bëjnë me financimin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar kapital të sigurimit pensional si vijon:

1. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërisë pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 71/2023);
2. Rregullore për planin kontabël, formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare bazë dhe raporteve shtesë për fondet e pensioneve të detyrueshme dhe vullnetare ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 71/2023);
3. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për vërtetimin me mendimin e aktuarit të autorizuar ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 71/2023);
4. Rregullore për metodologjinë e llogaritjes së mjeteve personale të shoqërisë pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 71/2023);
5. Rregullore për mënyrën dhe kohën e transferimit të mjeteve në fondet vullnetare pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 101/2023);
6. Rregullore për kompensimin e fondeve të detyrueshme pensionale ("Gazeta Zyrtare e RSM" Nr. 101/2023);
7. Rregullore për transferimin e mjeteve ndërmjet fondeve të detyrueshme pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV" Nr. 101/2023);
8. Rregullore për ndryshimin e Rregullores për mënyrën dhe kohën e transferit të mjeteve në fondet vullnetare pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 166/2023);
9. Rregullore për ndryshimin e Rregullores për agjentët e shoqërive pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 268/2023) dhe
10. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për procedurën e përzgjedhjes së personave juridikë vendas për kryerjen e shërbimeve me letra me vlerë ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 268/2023).

Ndryshimet e rregulloreve u bënë për shkak të precizimit të procedurave të caktuara. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërisë pensionale dhe Rregullorja për planin kontabël, formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare bazë dhe raporteve shtesë për fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale zgjeron llojin e informacionit që shoqëria pensionale e dorëzon në MAPAS, me qëllim të sigurimit të më shumë të dhënave për funksionimin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale dhe mundësohet dërgimin e raporteve financiare bazë dhe raporteve shtesë për shoqërinë pensionale, fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale përmes postës elektronike. Rregullorja për mënyrën dhe kohën e transferimit të mjeteve në fondet pensionale vullnetare dhe Rregullorja për transferimin e mjeteve ndërmjet fondeve të pensionit të detyrueshëm lehtësojnë dhe përmirësojnë procedurën për transferimin e mjeteve në fondet vullnetare dhe të detyrueshme pensionale, ndërsa në Rregulloren për kompensimin e fondeve të detyrueshme pensionale, përmirësohet procedura për ndryshimet në tarifat e ngarkuara nga shoqëritë. Me ndryshimin e Rregullores për agjentët e shoqërive pensionale, parashikohet dokumentacioni që shoqëria pensionale paraqet në MAPAS, si dëshmi i plotësimit të kushteve për dhënien e provimit për agjent dhe detyrimi për të rinovuar regjistrimin e agjentit çdo 12 muaj shfuqizohet. Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përzgjedhjen e personave juridikë vendas për kryerjen e shërbimeve të letrave me vlerë përcakton procedurën për dhënien e pëlqimit për përzgjedhjen e personave juridikë vendas për kryerjen e shërbimeve të letrave me vlerë dhe përcakton dokumentacionin e nevojshëm, mënyrën e paraqitjes, kërkesën dhe dokumentacionin drejtuar MAPAS-it dhe afatin e vendimmarrjes nga MAPAS.

Të dhëna mbi punën financiare të shoqërive pensionale

4

Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2024

4.1

Rezultati financiar i shoqërive pensionale

4.2

Kapitali, kapitali themelor dhe mjetet personale të shoqërive të pensionale

4.3

Indikatorë

4.4

Të dhëna mbi punën financiare të shoqërive pensionale

Sava shoqëria pensionale sh.a. Shkup dhe KB e Para shoqëria pensionale SH.A. Shkup edhe në vitin 2024 realizuan rezultat financiar pozitiv. Dy shoqëritë pensionale e përfunduan vitin 2024 me fitim neto dhe realizuan fitim të përgjithshëm gjithëpërfshirës, dhe atë: Sava Shoqëri Pensionale SH. A. Shkup në shumën prej rreth 174 milionë denarë dhe KB e Para Shoqëri Pensionale SH.A. Shkup në shumën prej rreth 227 milionë denarë. TRIGLLAV SHOQËRIA PENSIONALE SH.A. Shkup regjistron rezultat financiar negativ edhe në vitin e gjashtë të funksionimit të tij. Fondet pensionale të cilat i menaxhon kjo shoqëri kanë një numër relativisht të vogël anëtarësh dhe mjetet janë me vëllim më të vogël, gjë që ndikon në të ardhurat më të ulëta nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër ekzistojnë shpenzime të konsiderueshme për menaxhimin e shoqërisë dhe fondeve. VFP SHOQËRIA PENSIONALE SH.A. SHKUP regjistron gjithashtu rezultat financiar negativ edhe në vitin e tretë të funksionimit të tij. Ky rezultat është i zakonshëm dhe i pritshëm për vitet e para të funksionimit të një shoqërie pensionale.

Shoqëritë pensionale për veprimtarinë e tyre financiare përgatisin raporte financiare në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare, Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërisë pensionale, si dhe me Rregulloren për mbajtjen e kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në fuqi. Të dhënat, mbi bazën e të cilave janë bërë analizat në këtë kapitull, janë marrë nga raportet financiare vjetore të parikontrolluara të katër shoqërive pensionale, deri më 31.12.2024.

4.1 Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2024

Për kryerjen e veprimtarisë së vetme - menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale, shoqëritë pensionale financohen nëpërmjet kompensimeve të përcaktuara me ligj, përkatësisht paguajnë kompensim të kontributeve, kompensim të mjeteve të fondeve pensionale dhe kompensim për kalim. Gjithashtu, shoqëritë pensionale kanë edhe të ardhura financiare si rezultat i investimit të mjeteve të lira monetare në depozita dhe letra me vlerë, të cilat lejohen në përputhje me Ligjin për financim kapital vullnetar të sigurimit pensional. Të ardhurat e katër shoqërive pensionale janë dhënë në tabelën 4.1.

Tabela 4.1. Të ardhurat e shoqërive pensionale në vitin 2023

(në denarë)

Baza	SAVA		KB e para		TRIGLAV		VFP	
Të ardhurat nga menaxhimi me fondin e detyrueshëm pensional								
Kompensimi nga kontributet	111.191.976	30,51%	120.386.365	30,25%	23.224.653	41,28%	-	-
Kompensimi nga mjetet	198.851.718	54,56%	223.507.155	56,15%	25.721.475	45,71%	-	-
Kompensimi nga transferi	930	0,00%	0	0,00%	124.076	0,22%	-	-
Të ardhurat e përgjithshme nga menaxhimi me fondin e detyrueshëm pensional	310.044.624	85,07%	343.893.520	86,40%	49.070.204	87,21%	-	-
Të ardhurat nga menaxhimi me fondin pensional vullnetar								
Kompensimi nga kontributet	5.031.630	1,38%	4.772.001	1,20%	94.904	0,17%	339.597	21,78%
Kompensimi nga mjetet	14.463.511	3,97%	14.506.129	3,64%	92.938	0,17%	347.716	22,30%
Kompensimi nga transferi	615	0,00%	0	0,00%	0	0,00%	2.463	0,16%
Të ardhurat e përgjithshme nga menaxhimi me fondin vullnetar pensional	19.495.756	5,35%	19.278.130	4,84%	187.842	0,33%	689.776	44,23%
Të ardhurat financiare	33.538.009	9,20%	33.177.199	8,34%	5.894.152	10,48%	869.622	55,77%
Të ardhurat tjera të shoqërisë	1.371.763	0,38%	1.673.787	0,42%	1.113.831	1,98%	0	0,00%
Të ardhurat e përgjithshme	364.450.152	100,00%	398.022.636	100,00%	56.266.029	100,00%	1.559.398	100,00%

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre të vetme, shoqëritë pensionale kanë shpenzime, në përgjithësi, për menaxhimin e mjeteve të fondeve pensionale, për vlerësimin e mjeteve, për anëtarësimin, mbajtjen e llogarive të anëtarëve dhe për njoftimin e anëtarëve, si dhe për pagesën e kompensimeve për MAPAS-in, për Fondin e SIPMV-së dhe për rojtarin e pronës dhe për mbulimin e shpenzimeve lidhur me funksionimin e shoqërive pensionale. Shpenzimet e shoqërive pensionale janë ndarë në tri grupe: shpenzimet për menaxhimin e fondit të detyrueshëm pensional, shpenzimet për menaxhimin e fondit pensional vullnetar dhe shpenzimet për menaxhimin e shoqërisë. Shpenzimet e katër shoqërive pensionale janë dhënë në tabelën 4.2.

Tabela 4.2. Shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2023

(në denarë)

Baza	SAVA		KB e para		TRIGLAV		VFP	
Shpenzime për menaxhimin me fondin e detyruar pensional								
Shpenzime për agjentët e shoqërisë	5.296.211	2,41%	1.586.957	0,81%	14.460.189	17,48%	-	-
Shpenzime për marketing	23.455.212	10,69%	15.327.049	7,82%	4.732.938	5,72%	-	-
Shpenzime për transaksione	89.094	0,04%	0	0,00%		0,00%	-	-
Shpenzime për MAPAS	40.971.025	18,67%	44.360.103	22,62%	8.556.982	10,34%	-	-
Shpenzime për Kujdestarin e pasurisë	14.806.053	6,75%	17.663.973	9,01%	2.766.529	3,34%	-	-
Shpenzime për Fondin SPIMV	5.562.053	2,54%	6.333.537	3,23%	1.153.743	1,39%	-	-
Shpenzime të tjera nga menaxhimi me Fondin	1.172.205	0,53%	1.137.228	0,58%	1.243.000	1,50%	-	-
Shpenzime të përgjithshme për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional	91.351.853	41,64%	86.408.847	44,06%	32.913.381	39,78%	-	-

Shpenzime për menaxhimin me fondin vullnetar pensional								
Shpenzime për agjentët e shoqërisë	5.560.438	2,53%	1.454.059	0,74%	31.854	0,04%	62.078	0,63%
Shpenzime për marketing	1.387.471	0,63%	1.091.032	0,56%	14.482	0,02%	53.100	0,54%
Shpenzime për transaksione	63.030	0,03%	0	0,00%		0,00%		0,00%
Shpenzime për MAPAS	1.538.454	0,70%	1.373.783	0,70%	23.568	0,03%	10.517	0,11%
Shpenzime për Kujdestarin e pasurisë	2.228.386	1,02%	967.567	0,49%	5.193	0,01%	3.051	0,03%
Shpenzime të tjera nga menaxhimi me Fondin	106.438	0,05%	409.002	0,21%	20.000	0,02%	80.000	0,81%
Shpenzime të përgjithshme për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional	106.438	0,05%	409.002	0,21%	20.000	0,02%	80.000	0,81%
Shpenzime për menaxhimin me Fondin Vullnetar Pensional	10.884.217	4,96%	5.295.443	2,70%	95.097	0,11%	208.746	2,12%
Shpenzime për menaxhimin me shoqërinë								
Paga dhe kompensime për punonjësit	70.021.835	31,91%	52.287.290	26,66%	27.853.888	33,67%	4.664.183	47,34%
Shpenzime për shërbimet	16.179.354	7,37%	12.167.118	6,20%	13.295.631	16,07%	2.211.851	22,45%
Shpenzime për lëndë të para dhe materiale të tjera	2.858.101	1,30%	1.829.406	0,93%	911.846	1,10%	24.332	0,25%
Amortizimi	2.416.872	1,10%	4.651.258	2,37%	3.412.658	4,13%	1.325.637	13,46%
Shpenzime financiare	3.996.763	1,82%	12.185.914	6,21%	388	0,00%	296.707	3,01%
Shpenzime të tjera për funksionim	21.384.106	9,75%	21.297.916	10,86%	5.425.392	6,56%	1.120.842	11,38%
Rezervime për shpenzime dhe rreziqe	311.607	0,14%	0	0,00%	-1.177.337	-1,42%	0	0,00%
Shpenzime të përgjithshme për menaxhim me shoqërinë	117.168.638	53,40%	104.418.902	53,24%	49.722.466	60,10%	9.643.552	97,88%
Gjithsej shpenzime	219.404.708	100,00%	196.123.192	100,00%	82.730.944	100,00%	9.852.298	100,00%

* Për shpenzimet, të dhëna që nuk mund të ndahen, sipas fondit të pensionit të detyrueshëm dhe atij vullnetar, shoqëria e pensioneve përdor numrin e anëtarëve në fondin e pensionit të detyrueshëm dhe atë vullnetar si ponder për ndarje.

Në kuadër të anës të ardhurave dhe te SAVA dhe KB e Para vërehet rritje të të ardhurave të përgjithshme në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 dhe atë afro 16% te SAVA dhe 14% te KB e Para. Kështu, pjesa më e madhe e të ardhurave të SAVA dhe KB e Para, në vitin 2023, rrjedh nga kompensimet e mjeteve nga fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (rreth 60% edhe te SAVA dhe 62% te KB e Para), me ç'rast vijon kompensimi nga kontributet në fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (rreth 30% edhe në SAVA edhe në KB e Para). Lidhur me vitin paraprak, pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave nga kompensimet nga kontributet, në të ardhurat e përgjithshme, edhe te të dyja shoqëritë pensionale është ulur (për rreth dy pikë përqindje te SAVA dhe rreth një pikë përqindje te KB e Para). Pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave nga kompensimi mbi fondet është rritur për rreth një pikë përqindjeje te SAVA dhe për rreth dy pikë përqindjeje te KB e Para. Në krahasim me vitin 2023, pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave financiare te SAVA është rritur për rreth një pikë përqindjeje, ndërsa te KB e Para ka mbetur në nivel të ngjashëm. Pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave të tjera është më e ulëta (më pak se 1%) te të dyja shoqëritë pensionale.


Në suazat e shpenzimeve në vitin 2024, në krahasim me vitin 2023, si te SAVA ashtu edhe te KB e Para, është vërejtur rritje e shpenzimeve të përgjithshme: rreth 8% te SAVA, rreth 3% te KB Para. Kështu, te SAVA, pjesa më e madhe e shpenzimeve

rreth 55% e shpenzimeve lidhen me veprimtarinë e shoqërisë ku pjesa më e madhe përbëhet nga pagat dhe kompensimet për të punësuarit, vijnë shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet e tjera operative. Te KB e Para në vitin 2024 shpenzimet që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë janë rreth 50%. Përsëri, pjesa më e madhe janë pagat dhe kompensimet për të punësuarit, pastaj shpenzimet e tjera operative dhe shpenzimet për shërbime. Pjesa tjetër e shpenzimeve 45% në SAVA, përkatësisht 50% e shpenzimeve në KB e Para kanë të bëjnë me shpenzimet për menaxhimin e fondeve pensionale. Ndërkohë, shpenzimet për marketing dhe agjentë përbëjnë rreth 14% të shpenzimeve totale të SAVA dhe rreth 11% të KB e Para, që në krahasim me vitin e kaluar nënkupton se janë ulur për dy pikë përqindjeje të SAVA dhe janë rritur për një pikë përqindjeje të KB e Para. Rreth 31% e shpenzimeve të SAVA dhe 39% e shpenzimeve të KB e Para u përkasin kompensimeve për MAPAS, Fondin e SPIRMV-së dhe për ruajtësit e pronës.

TRIGLLAV filloi aktivitetet për menaxhimin e fondeve pensionale dhe punët e marketingut për fondin e detyrueshëm dhe vullnetar pensional dhe analizën e opinionit publik më 1.4.2019. Fondi i hapur pensional vullnetar Trigllav – Shkup filloi punën më 1.3.2021. Ekziston një dallim në shumën dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në krahasim me SAVA dhe KB e Parë, të cilët operojnë prej nëntëmbëdhjetë vitesh. Në vitin 2024, edhe te TRIGLLAV, në anën e të ardhurave, pjesëmarrja më e madhe u përket të ardhurave nga kompensimi mbi fondet, përkatësisht rreth 48% të të ardhurave totale. Pjesëmarrja e të ardhurave nga kompensimi mbi kontributet në vitin 2024 është ulur dhe arrin në 37%. Mandej, të ardhurat financiare përbëjnë rreth 11% të të ardhurave totale të TRIGLLAV, ndërsa pjesëmarrja më e vogël është nga të ardhurat e tjera (rreth 3%). Kështu, pjesa më e madhe e shpenzimeve rreth 58% e shpenzimeve lidhen me veprimtarinë e shoqërisë ku pjesa më e madhe përbëhet nga pagat dhe kompensimet për të punësuarit, vijnë shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet e tjera operative. Shpenzimet për menaxhimin e fondeve pensionale arrijnë në rreth 42%. Kështu, shpenzimet për marketing dhe agjentë përbëjnë rreth 23% të shpenzimeve totale. Rreth 18% e shpenzimeve i përkasin kompensimeve për MAPAS, Fondin e SPIRMV-së dhe për ruajtësit e pronës dhe rreth 11% përbëjnë shpenzime të tjera nga menaxhimi i fondeve pensionale.


VFP filloi aktivitetet për menaxhimin e fondeve pensionale dhe punët e marketingut për fondin e detyrueshëm dhe vullnetar pensional dhe analizën e opinionit publik më 1.8.2023. VFP menaxhon vetëm me fond pensional vullnetar, dhe të ardhurat dhe shpenzimet e VFP-së i përkasin vetëm funksionimit të këtij fondi pensional vullnetar. VFP Fondi i Hapur Pensional Vullnetar – Shkup filloi punën më 18.10.2022, kur u realizua pagesa e parë e kontributit vullnetar. Vërehet një ndryshim i dukshëm në shumën dhe shpërndarjen sipas bazës së të ardhurave dhe shpenzimeve në krahasim me shoqëritë e tjera pensionale që menaxhojnë edhe me fond pensioni të detyrueshëm. Te VFP, në anën e të ardhurave, pjesën më të madhe e përbëjnë të ardhurat financiare – rreth 44% e të ardhurave totale, më pas ndjekin të ardhurat nga kompensimi mbi mjetet – rreth 33% dhe të ardhurat nga kompensimi mbi kontributet – rreth 23%. Kështu, pjesa më e madhe e shpenzimeve rreth 98% e shpenzimeve i përkasin operimit të shoqërisë, ku shpenzimet më të mëdha janë për paga dhe kompensime për të punësuarit, pasuar nga shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet për amortizim të punës. Shpenzimet për menaxhimin e fondit pensional vullnetar përbëjnë rreth 2%. Kështu, shpenzimet për marketing dhe agjentë përbëjnë rreth 1% të shpenzimeve totale. Pjesëmarrja në shpenzimet që lidhen me kompensimet për MAPS dhe për ruajtësit e pronës është më e vogël se 1%

Grafiku 4.1. Struktura e të ardhurave për shoqëri, për vitet 2022 dhe 2023



Grafiku 4.2. Struktura e shpenzimeve për shoqëri, për 2022 dhe 2023

(në denarë)



4.2 Rezultati financiar i shoqërive pensionale

SAVA dhe KB e Para edhe në vitin 2024 realizuan rezultat financiar pozitiv. Të dyja shoqëritë pensionale e përfunduan vitin 2024 me fitim neto (fitim pas tatimit). KB e Para ka realizuar fitim neto më të madh se SAVA, kryesisht për shkak se KB e Para ka realizuar të ardhura më të larta dhe njëkohësisht ka pasur më pak shpenzime se SAVA, për vitin 2024. SAVA në vitin 2024 ka shënuar fitim neto më të madh në krahasim me vitin 2023 për 22%, ndërsa KB e Para ka shënuar fitim neto më të madh për 20%. Gjithashtu, të dy shoqëritë pensionale realizuan fitim të përgjithshëm gjithëpërfshirës, SAVA në shumën prej rreth 174 milionë denarësh, KB e Para në shumën prej rreth 227 milionë denarësh. Fitimi i akumuluar (deri më 31.12.2024) i SAVA-s është rreth 506 milionë denarë, ndërsa i KB e Para është rreth 477 milionë denarë. TRIGLLAV regjistron rezultat financiar negativ edhe në vitin e gjashtë të funksionimit të tij. Në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon TRIGLLAV ende marrin pjesë një numër relativisht i vogël anëtarësh dhe fondet janë me vëllim të vogël, gjë që ndikon në shumën më të ulët të të ardhurave, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, ka shpenzime të konsiderueshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës së shoqërisë dhe të punësuarve, shpenzime për marketing si dhe shpenzime operative për menaxhimin e fondit. Gjithashtu, fondi vullnetar pensional me të cilin menaxhon TRIGLLAV funksionon për më pak se katër vjet dhe ka numër të vogël anëtarësh dhe fond me vëllim të ulët. VFP regjistron gjithashtu rezultat financiar negativ edhe në vitin e tretë të funksionimit të tij. Ky rezultat është i zakonshëm dhe i pritshëm për vitet e para të funksionimit të një shoqërie pensionale. VFP menaxhon vetëm me fond pensional vullnetar, i cili filloi punën në tetor të vitit 2022 dhe në të marrin pjesë pak anëtarë, ndërsa fondet janë me vëllim të ulët, që ndikon në të ardhura të ulëta, kurse njëkohësisht ka shpenzime të konsiderueshme për ngritjen e sistemit, infrastrukturën

Tabela 4.3. Rezultatet financiare të shoqërive pensionale për vitin 2023.

(në denarë)

Përshkrimi*	SAVA	KB e para	TRIGLAV	VFP
Fitimi/Humbja (për vitin 2023)	145.045.444	201.899.444	-26.464.915	-8.793.907
Fitimi/Humbja pas tatimit (për vitin 2023)	120.773.281	154.258.460	-40.620.620	-4.347.729
2023)	135.301.683	188.790.529	-26.464.915	-8.793.907
Shpenzime të parregullta	0	0	0	0
Fitimi neto (për vitin 2023)	135.301.683	188.790.529	-26.464.915	-8.793.907
Fitimi tjetër gjithëpërfshirës**	3.103.758			
Fitimi total gjithëpërfshirës***	138.405.441	188.790.529	-26.464.915	-8.793.907
Fitimi i akumuluar/ Humbja e transferuar (deri më 31.12.2023)	485.747.124	475.744.354	-130.329.698	-13.141.636

*Të dhënat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse janë nga pasqyrat financiare të audituara të kompanive të pensionit për vitin 2023.

** Të dhënat për të ardhurat e tjera përmbledhëse përfshin fitime ose humbje të përcaktuara, të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave.

*** Të dhënat totale të të ardhurave gjithëpërfshirëse përfshin të ardhurat neto dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

e shoqërisë, punonjësit, marketingun si dhe shpenzimet operative për menaxhimin e fondit. Të dhëna më të detajuara për rezultatin financiar të shoqërive pensionale janë paraqitur në tabelën 4.3.

4.3 Kapitali, kapitali themelor dhe mjetet personale të shoqërive të pensionale

Është shumë e rëndësishme për sistemin dhe për anëtarët që shoqëritë pensionale të jenë institucione të fuqishme dhe të qëndrueshme dhe të kenë kapital themelor adekuat. Tre shoqëritë pensionale menaxhojnë me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe duhet të kenë kapital themelor në lartësi prej së paku 1.8% milionë euro, në kundërvlerë me denarë, sipas kursit mesatar të BPRMV-së, ndërsa një shoqëri pensionale menaxhon vetëm me fondin pensional vullnetar dhe duhet të ketë kapital themelor në lartësi prej së paku 0,5 milionë euro, në kundërvlerë me denarë, sipas kursit mesatar të BPRMV-së. Në rastin e zmadhimit të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe/ ose vullnetar me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar që ta rrisë kapitalin në pajtim me dispozitat ligjore.

Kapitali themelor i shoqërisë pensionale paguhet vetëm në mjete monetare. Me qëllim për ta rritur fuqinë financiare të shoqërisë pensionale, nuk lejohet që kapitali themelor të rrjedhë nga huat dhe kreditë dhe nuk mund të ngarkohet në çfarëdo mënyre. Kapitali themelor i shoqërisë duhet të rrjedhë me doemos nga burimet ligjore dhe të tatimohet në pajtim me dispozitat e RMV-së dhe me rregullat e vendit në të cilin çdo aksionar i huaj është themeluar si person juridik.

Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë, ta mbajë shumën e kapitalit por jo më pak se një gjysmë të shumës së kapitalit themelor. Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë, të mbajë mjete personale, në shumë jo më të vogël se një gjysmë e shumës së kapitali.

Tabela 4.4. Kapitali, kapitali themelor dhe mjetet e shoqërive pensionale

(në denarë)

Përshkrimi	SAVA	KB e para	TRIGLAV	VFP
Kapitali dhe rezervat	760.295.104	817.529.255	234.066.407	22.318.039
Kapitali themelor	130.001.478	110.459.024	390.861.020***	35.459.675****
Kapitali shtesë mbi minimumin e përcaktuar me ligj	23,63%	32,94%	35,94%	44,70%
Mjetet vetanake*	706.840.824	739.577.385	220.621.573	18.871.054
Mjete shtesë (excess) individuale mbi minimumin e caktuar me ligj **	129,87%	140,53%	156,26%	22,35%

*Mjetet vetanake llogariten në përputhje me Rregulloren për metodologjinë e llogaritjes së mjeteve vetanake të shoqërisë pensionale.

** Në përputhje me detyrimin ligjor, SAVA, nga prilli 2023, detyrohet të mbajë një kapital të shtuar në raport me kapitalin bazë, d.m.th. kapital në vlerë prej 10 milionë euro në kundërvlerë në denarë, për faktin se shuma e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, me të cilin ai menaxhon, tejkaloi shumën prej 900 milionë euro. KB e Parë, nga nëntori i vitit 2021, është e detyruar të mbajë një kapital të shtuar në raport me kapitalin bazë, d.m.th. kapital në vlerë prej 10 milionë euro në kundërvlerë në denarë, për faktin se shuma e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, me të cilin ai menaxhon, tejkaloi shumën prej 900 milionë euro.

***Në korrik 2023, TRIGLAV e rriti kapitalin aksionar me 1.000.000 euro duke emetuar aksione të zakonshme me të drejtë vote nga emetimi i tretë përmes ofertës private, me të cilën kapitali aksionar arrin në 6.356.000 euro. Rritja e kapitalit bazë të shoqërisë bëhet me qëllim të mbajtjes së sasisë së kërkuar të kapitalit në përputhje me ligjin.

****Në shtator 2023, VFP rriti kapitalin aksionar me 75.000 euro duke emetuar aksione të zakonshme me të drejtë vote nga emetimi i dytë me anë të një oferte private, me të cilën kapitali aksionar arrin në 575.000 euro. Rritja e kapitalit bazë të shoqërisë bëhet me qëllim të mbajtjes së sasisë së kërkuar të kapitalit në përputhje me ligjin.

4.4 Indikatorë

Gjatë analizës së të dhënave financiare të shoqërive pensionale është e rëndësishme lëvizja e treguesve të caktuar për anëtar si dhe koeficienti për efikasitet. Në tabelën 4.5 janë paraqitur treguesit më të rëndësishëm për anëtar dhe koeficienti për efikasitet të të katër shoqërive pensionale për vitin 2022.

Tabela 4.5. Treguesit

(në denarë)

Përshkrimi	SAVA	KB e para	TRIGLAV	VFP
Indikatorët për të ardhurat dhe shpenzimet për çdo anëtar				
Të ardhura mesatare për çdo anëtar	1.337,41	1.349,57	992,98	3.643,45
Shpenzime mesatare për çdo anëtar	805,14	664,99	1.460,03	24.189,96
Fitimi/Humbja për çdo anëtar	532,27	684,58	-467,05	-20.546,51
Koeficienti i efikasitetit (totali i shpenzime / totali i të ardhurave)	60,20%	49,27%	147,04%	663,93%

Në krahasim me vitin 2023, të ardhurat mesatare për anëtar shënojnë rritje prej 14% te SAVA, 13% te KB e Parë, 19% te TRIGLLAV dhe 45% te VFP. Më pas, në krahasim me vitin 2023, shpenzimet mesatare për anëtar shënojnë rritje prej 6% te SAVA dhe 1% te KB Parë, ndërsa te TRIGLLAV shënojnë ulje prej 4% dhe te VFP ulje prej 18%. Gjithashtu, te SAVA ka rritje të fitimit për anëtar në krahasim me vitin 2023 në masë prej rreth 26%, dhe edhe te KB e Para ka rritje prej rreth 23%. Gjithashtu vërehet se koeficienti i efikasitetit të SAVA dhe KB e Para tregon ulje në krahasim me vitin 2022. Në vitin 2024, TRIGLLAV shënon ulje të humbjes për anëtar prej rreth 19% në krahasim me vitin 2023, por koeficienti i efikasitetit ende tregon përfaqësim të madh të shpenzimeve totale në raport me të ardhurat totale. Gjithashtu edhe VFP shënon ulje të humbjes për anëtar në vitin 2024 prej rreth 44%, ndërsa njëkohësisht koeficienti i efikasitetit ende tregon përfaqësim të madh të shpenzimeve totale në raport me të ardhurat totale.

Në Grafikun 4.3 dhe Tabela 4.6 janë paraqitur lëvizjet e indikatorëve të profitabilitetit ROA (fitimi neto/aktivet totale) dhe ROE (fitimi neto/kapitali), në krahasim për SAVA dhe KB e Para për periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2024, për TRIGLAV për periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2024 dhe për VFP nga viti 2022 deri në vitin 2024. Mund të vërehet se, në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, norma e kthimit nga aktivet (ROA) shënon një rritje shumë të vogël si te SAVA ashtu edhe te KB e Para. Gjithashtu, edhe norma e kthimit nga kapitali (ROE) në vitin 2024, në krahasim me vitin 2023, shënon rritje te të dyja shoqëritë, SAVA dhe KB e Para. Koeficientët ROA dhe ROE për TRIGLAV dhe VFP janë zmadhuar, por ende mbeten negativë.

Grafiku 4.3. ROA dhe ROE sipas shoqërive dhe sipas vitit





Tabela 4.6. Treguesit e përfitimit

Shoqëri Pensionale	SAVA		KB e para		TRIGLAV		VFP	
Viti / Përshkrim	ROA	ROE	ROA	ROE	ROA	ROE	ROA	ROE
2006	-0,60%	0,00%	-2,69%	-4,45%				
2007	4,97%	5,57%	7,19%	10,19%				
2008	18,66%	20,55%	21,30%	28,53%				
2009	15,09%	16,26%	21,80%	26,54%				
2010	16,66%	17,60%	20,24%	23,00%				
2011	14,09%	14,75%	20,02%	22,03%				
2012	15,21%	15,84%	20,84%	22,31%				
2013	18,88%	19,68%	22,71%	23,80%				
2014	13,94%	15,09%	22,35%	23,71%				
2015	14,77%	15,65%	20,20%	21,00%				
2016	16,34%	17,34%	20,23%	21,09%				
2017	16,35%	17,23%	22,89%	23,78%				
2018	16,79%	17,49%	22,96%	23,71%				
2019	13,70%	14,26%	20,52%	21,24%	-10,99%	-11,55%		
2020	14,13%	15,43%	19,66%	21,29%	-23,13%	-24,18%		
2021	15,38%	15,96%	22,46%	20,82%	-38,77%	-40,54%		
2022	16,84%	17,44%	19,23%	19,78%	-19,81%	-20,41%	-15,07%	-16,41%
2023	16,97%	17,80%	22,41%	23,09%	-10,81%	-11,31%	-38,27%	-39,40%

5 Informacione për fondet e detyrueshme pensionale

- 5.1 Anëtarësimi në fondet e detyrueshme pensionale
- 5.2 Të dhëna për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale
- 5.3 Kalimi i anëtarit nga një fond në tjetër fond të detyrueshëm pensional
- 5.4 Kontributet në fondet e detyrueshme pensionale
- 5.5 Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve të detyrueshme pensionale
- 5.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe shkalla e rendimentit të fondeve të detyrueshme pensionale
- 5.7 Kompensimet tek fondet e detyrueshme pensionale
- 5.8 Pagesa e pensioneve nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital

5. Informacione për fondet e detyruara pensionale të detyrueshme

Numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i të siguruarve të shpërndarë përkohësisht në shtyllën e dytë në vitin 2024 u rrit për rreth 3,01% dhe deri në fund të vitit 2024 është 610.855. Lëvizja në trendin e kalimeve të anëtarëve nga një fond pensional i detyrueshëm në një tjetër, që u nxit me fillimin e funksionimit të fondit të tretë pensional të detyrueshëm në vitin 2019, vazhdoi edhe në vitin 2024, ku 2.37% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve kanë kaluar nga një fond i detyrueshëm pensional në tjetrin.

Gjatë vitit 2024, në fondet e detyrueshme pensionale janë transferuar kontribute në vlerë prej rreth 15,48 miliardë denarë. Përveç kontributeve Fondi i SPIRMV-së transferoi gjithsej rreth 0,95 milionë denarë si kompensim për transferim jo në kohë të kontributeve për anëtarët për të cilët nuk i ka transferuar kontributet në llogaritë e fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kontributeve.

Gjatë vitit 2024, mjetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale shënuan rritje prej 20,45% dhe arritën në 162,85 miliardë denarë, që përfaqëson rreth 17,16% të BPV-së së RMV-së. Struktura e investimeve të mjeteve pensionale në vitin 2024 nuk dallon shumë në krahasim me vitin 2023. Portofoli investues i fondeve të detyrueshme pensionale në vitin 2024 përbëhet nga investime vendore që përfshijnë letra me vlerë shtetërore (64,93%), depozita (1,68%), aksione (2,02%) dhe pjesëmarrje në fonde investuese (0,43%); si dhe investime të huaja që përfshijnë obligacione shtetërore të huaja (0,90%), obligacione korporative (0,15%), pjesëmarrje në fonde investuese (25,70%) dhe aksione (3,29%).

Në vitin 2024 vazhdoi trendi i rritjes së vlerave të njësive llogaritëse të tre fondeve të detyrueshme pensionale (9,24% për SAVAd, 9,23% për KBPd dhe 9,94% për TRIGLAVd).

Në lidhje me kthimin e fondeve pensionale, në vitin 2024 është vërejtur një rritje e vogël e kthimit si në shumën nominale, ashtu edhe në atë reale, për periudhën shtatëvjeçare 2018 - 2024, si për fondet e detyrueshme ashtu edhe për fondet vullnetare pensionale. Megjithatë, rritja e ndryshimit të nivelit të kostos së jetesës, e llogaritur në nivel vjetor, ndikon ende dukshëm mbi shumën e të ardhurave në vlerën reale edhe në vitin 2024. Në shtyllën e dytë, për periudhën 2018 - 2024 u realizua një kthim mesatar vjetor prej 5,03% në shumë nominale, përkatësisht 0,16% në shumë reale, i llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive kontabël të fondeve të detyrueshme pensionale.

Në vitin 2024 janë realizuar pensione dhe pagesa për 616 anëtarë në shtyllën e dytë.

5.1 Anëtarësimi në fondet e detyrueshme pensionale

Një i siguruar mund të fitojë anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional në dy mënyra:

1) me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve që e mban MAPAS-i;

2) me vendosje në fondin e detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes së rastit, nga ana e Fondit të SIPMV, në rast kur i siguruari, i cili është i detyruar të bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional, nuk ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në periudhën për zgjedhje të fondit të detyrueshëm pensional dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve që e mban MAPAS-i.

Ekzistojnë dy kategori të të siguruarve që janë anëtarë në shtyllën e dytë:

- Anëtarë të detyrueshëm –
 - o të siguruarit që janë punësuar, përkatësisht që janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, për herë të parë pas 1 janarit 2003 dhe që janë lindur pas 1 janarit 1967;
 - o të siguruarit që janë punësuar, përkatësisht në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, për herë të parë pas 1 janarit 2019 dhe të cilat në datën e anëtarësimit janë më të rinj 40 vjet.
- Anëtarë vullnetarë –
 - o të siguruarit që janë punësuar për herë të parë para 1 janarit 2003 të cilat sipas zgjedhjes personale me lidhje të marrëveshjes për anëtarësim janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital dhe që kanë lindur pas 1 janarit 1967;
 - o të siguruarit që janë punësuar për herë të parë, para 1 janarit 2003, të cilat sipas zgjedhjes personale me lidhje të marrëveshjes për anëtarësim janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, kanë lindur para 1 janarit 1967 e që kanë nënshkruar deklarata për vazhdimin e anëtarësisë në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim

kapital.


Të siguruarit të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar dhe të siguruarit që përkasin në kapitullin VII “Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve nën kushte të veçanta të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor” (të punësuarit me stazh të beneficuar në MPB, shtëpitë korrigjuese-penale, ARM dhe ngjashëm) nuk përfshihen në shtyllën e dytë, nëse kanë stazh të mbushur të sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë për minimum një vit. Kur të siguruarit që janë anëtarë të fondit të detyrueshëm pensional do të mbushin stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar që mundëson uljen e kufirit të pleqërisë për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit në përputhje me nenin 118 paragrafi (3) i Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, kanë të drejtë të zgjedhin për ta vazhduar anëtarësimin në shtyllën e dytë me deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajsh nga mbushja e stazhit të sigurimit. Nëse këta anëtarë nuk japin deklaratë me shkrim, u ndërpritet anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional pas skadimit të këtij afati.

5.2 Të dhëna për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale

Të siguruarit që janë anëtarë të detyrueshëm në financimin kapital të sigurimit pensional janë të detyruar të anëtarësohen në fondin e detyrueshëm pensional, në afat prej tre muajsh, llogaritur nga data e punësimit të parë. Fondi i SIPMV-së, i vendos përkohësisht këta të siguar në fondet e detyrueshme pensionale, sipas zgjedhjes së rastit, nga momenti i punësimit të tyre, me qëllim mjetet e tyre të investohen menjëherë pas punësimit. Nëse në afatin ligjor nuk nënshkruajnë kontratë për anëtarësim me asnjë shoqëri, këto të siguar mbeten anëtarë të fondit të detyrueshëm pensional në të cilin janë sistemuar përkohësisht paraprakisht.

Ponderi, sipas të cilit bëhet sistemimi i përkohshëm i të siguarve në fondet e detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit, përcaktohet nga ana e MAPAS-it për secilin fond të detyrueshëm pensional, në ditën e parë të punës të secilit muaj. Ponderi varet nga vlera e kompensimit nga kontributet që e paguan shoqëria pensionale dhe nga të ardhurat në shumën minimale që e ka realizuar fondi pensional, me ç’rast ndikim më të madh kanë të ardhurat (70%) në krahasim me kompensimin nga kontributet (30%)⁴. Ponderët që janë shfrytëzuar për sistemim të të siguarve në fondet e detyrueshme pensionale, gjatë vitit 2022, janë paraqitur në grafikun 5.1.

Grafiku 5.1. Ponderi për sistemim të anëtarëve në fondet e detyrueshme pensionale



Duke filluar nga prilli i vitit 2019, personat e siguar shpërndahen në tre fonde të detyrueshme pensionale për shkak se më datë 01.04.2019 ka filluar të funksionojë fondi pensional i detyrueshëm TRIGLLAVd. Në maj 2022 ka kaluar periudha e mbështetjes për funksionimin e një fondi të ri pensioni të detyrueshëm në lidhje me shpërndarjen e personave të siguar në përputhje me dispozitat në rregullore. Duke marrë parasysh faktin se në vitin 2024, tri shoqëritë pensionale kanë ngarkuar kompensim nga kontributet në të njëjtën masë, shumat e ponderimit janë ndikuar më shumë nga shumat e të ardhurave të realizuara të fondeve të detyrueshme pensionale. Në vitin 2024, ponderi i TRIGLLAVd është më i ulët në krahasim me SAVAd dhe KBPd sepse të ardhurat e TRIGLLAVd gjatë kësaj periudhe ishte më i ulët. Gjithashtu, gjatë gjithë vitit 2024, vlera e ponderimit e

KBPd është pak më e lartë (mesatarisht me një pikë përqindje) në raport me vlerën e ponderimit të SAVAd.

⁴ Formula për përllogaritje të ponderit është përcaktuar në Rregulloren për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional.


Numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i të siguruarve të shpërndarë përkohësisht në fondet pensionale të detyrueshme, deri më 31 dhjetor 2024, arrin në 610.855, që paraqet një rritje të numrit të anëtarëve në shtyllën e dytë prej 17.832 ose rreth 3,01% krahasuar me vitin 2023. Rritja e anëtarësimit në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ruan përafërsisht të njëjtin nivel si vitin e kaluar.

Sa i përket shpërndarjes së anëtarësimit sipas fondeve pensionale të detyrueshme, edhe në vitin 2024 numri më i madh i të siguruarve janë anëtarë të SAVAd dhe KBPd. Kështu, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas fondeve pensionale të detyrueshme, me gjendje më 31.12.2024, 46,05% janë në KBPd, 42,84% janë në SAVAd dhe 11,11% janë në TRIGLLAVd. Në krahasim me vitin 2023, vërehet një ulje e përqindjes së anëtarësimit si në SAVAd ashtu edhe në KBPd (për rreth një pikë përqindje), ndërsa një rritje e pjesëmarrjes për TRIGLLAVz (për rreth dy pikë përqindje).

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të shtyllës së dytë, 61.556 ose 10% janë anëtarë vullnetarë, ndërsa 549.299 ose 90% janë anëtarë të detyrueshëm. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të detyrueshëm, 200.212 anëtarë kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi, 318.841 nuk kanë nënshkruar kontratë dhe janë shpërndarë përfundimisht, ndërsa 30.246 të siguruar janë shpërndarë përkohësisht. Në vitin 2024 vërehet një ulje e numrit të të siguruarve të rinj që nënshkruajnë kontratë anëtarësimi krahasuar me vitin e kaluar. Konkretisht, mund të vihet re se rreth 12% e të siguruarve që kanë detyrim të anëtarësohen në fondin pensional të detyrueshëm gjatë vitit 2024 dhe për të cilët ka përfunduar afati për zgjedhjen e fondit, kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim, ndërsa pjesa tjetër, rreth 88%, nuk kanë nënshkruar kontratë dhe kanë mbetur në fondin ku janë shpërndarë më parë.

Në strukturën e anëtarëve dhe të të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit, në vitin 2024, nuk ka pasur ndryshime të papritura apo të rëndësishme për SAVAd dhe KBPd. Struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit në vitin 2024 është e ngjashme te SAVAd dhe KBPd. Gjithashtu, mund të vërehet se në çdo tremujor përqindja e anëtarëve vullnetarë zvogëlohet, ndërsa pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm rritet, gjë që është e pritshme, pasi çdo vit rritet fluksi i anëtarëve të detyrueshëm. Gjithashtu, mund të vërehet se përqindja e anëtarëve të detyrueshëm që kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi gradualisht po zvogëlohet nga tremujori në tremujor, në kundërshtim me përqindjen e anëtarëve të detyrueshëm që janë shpërndarë përfundimisht, e cila gradualisht po rritet nga tremujori në tremujor. Pas më shumë se pesë viteve të funksionimit, struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit në TRIGLLAVd ende ndryshon nga struktura në SAVAd dhe KBPd. Përqindja e anëtarëve vullnetarë te TRIGLLAVd është më e ulët krahasuar me atë te SAVAd dhe KBPd, ndërsa përqindja e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht është më e lartë te TRIGLLAVd në krahasim me SAVAd dhe KBPd. Anëtarët vullnetarë në TRIGLLAVd janë të siguruar që kanë nënshkruar kontratë për kalim nga SAVAd ose KBPd në TRIGLLAVd. Gjithashtu, mund të vërehet se përqindja e anëtarëve të detyrueshëm që kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi gradualisht po zmadhohet nga tremujori në tremujor, në kundërshtim me përqindjen e anëtarëve të detyrueshëm që janë shpërndarë përfundimisht, e cila gradualisht po zmadhohet nga tremujori në tremujor. Struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas fondeve pensionale të detyrueshme dhe sipas statusit të anëtarësimit në vitin 2024 është paraqitur në nivel tremujor në grafikun 5.2.


Grafiku 5.2. Struktura e anëtarëve dhe e personave të siguruar përkohësisht të alokuar sipas statusit të anëtarësimit dhe FDP




¹⁹ Formulat për llogaritjen e rendimentit në vlerë nominale dhe reale janë të përcaktuara në Rregulloren për vlerësimin e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

²⁰ Deri në miratimin e ndryshimeve në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital nga janari vitit 2013, rendimenti i fondit të pensionit të detyrueshëm është llogaritur për një periudhë 3-vjeçare, vetëm në shumën nominale.


Rendimenti në shumën nominale 18 paraqet ndryshimin (rritjen) në përqindjet të vlerës së njësisë së kontabilitetit në datën e fundit të vlerësimit të periudhës së llogaritjes dhe vlerës së njësisë së kontabilitetit në ditën e fundit të muajit që paraprin muajit të parë të periudhës së llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën nominale. Rendimenti në shumën reale, për çdo periudhë të llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën reale, llogaritet në bazë të shkallës vjetore të kontributit në shumën nominale dhe ndryshimit të nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhën e llogaritjes, të reduktuar në nivel vjetor. Kontributi i fondeve të detyrueshme pensionale, sipas periudhave, i reduktuar në nivel vjetor, është paraqitur në Tabelën 5.12 financiare botërore, të cilat shënuan luhatshmëri më të madhe gjatë vitit 2018 dhe zvogëlim në fund të vitit 2018. Gjatë së llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën nominale. Rendimenti në shumën reale, për çdo periudhë të llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën reale, llogaritet në bazë të shkallës vjetore të kontributit në shumën nominale dhe ndryshimit të nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhën e llogaritjes, të reduktuar në nivel vjetor. Kontributi i fondeve të detyrueshme pensionale, sipas periudhave, i reduktuar në nivel vjetor, është paraqitur në Tabelën 5.12 financiare botërore, të cilat shënuan luhatshmëri më të madhe gjatë vitit 2018 dhe zvogëlim në fund të vitit 2018. Gjatë vitit 2019 shënohet rritja graduale e rendimenteve. Në vitin 2020 shënohen kontribute më të vogla krahasuar me vitin 2019 në SAVAd dhe KBPD, më së shumti për shkak të gjendjeve të pavolitshme në tregjet financiare në kushtet e pandemisë së virusit

Grafiku 5.25. Rendimenti i FDP-së

(ne shume nominale)



Grafiku 5.26. Kontributi në shumën nominale dhe reale të FDP-së, 2013 - 2023



Korona. TRIGLAVd në vitet e para të punës së tij dhe në rrethana të jashtëzakonshme për shkak të gjendjeve të pavolitshme në tregjet financiare në kushtet e pandemisë së virusit korona, shënoi kontribut në shumën nominale më të vogël se zero, i cili tashmë u kompensua në periudhën e ardhshme. Pas rënies së rendimenteve në vitin 2022 për shkak të krizës globale të shkaktuar nga konflikti ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë, në vitin 2023 dhe 2024 vihet re një rritje e lehtë e rendimenteve për tre fondet pensionale.

Lëvizja e rendimentit në shumën nominale dhe reale, në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2023 (në nivel vjetor) dhe në vitin 2024 (në nivel tremujor), pas periudhave shtatëvjeçare, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të rendimentit, për

fondin e detyrueshëm pensional, mund të shihen në Grafikun 5.26. Në këtë grafik është paraqitur edhe lëvizja e rendimentit në shumën nominale dhe reale në TRIGLAVd, për periudhat përkatëse në përputhje me rregullativën, sepse ekziston më gjatë se 12 muaj, por më pak se 84 muaj. Në vitin 2024 rendimentit edhe në vlera nominale edhe në vlerar eale regjistroi rritje edhe tek SAVAd (nga 5,12% në 5,64% në nominale dhe nga 0,51% në 0,74% në vlera reale) dhe në KBPd (nga 5,23% në 5,75% në vlerë nominale dhe nga 0,63% në 0,84% në vlerë reale). Më pas, shumën më të ulët e rendimentit në shumën nominale dhe në shumën reale është shënuar në tremujorin e tretë në fondet pensionale që ekzistojnë prej më shumë se shtatë vitesh. Rendimenti i fondit të tretë të detyrueshëm pensional që filloi të punojë në prill 2019, në vitin 2024 shënoi rritje edhe në shumën nominale (nga 3,40% në 4,55%) edhe në vlerën reale (nga -2,76% në -1,34%). Në periudhën në shqyrtim (2013-2024), ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhat e llogaritjes, të reduktuar në nivel vjetor, deri në vitin 2019 shënoi rënie, gjë që ndikon në afrimin gradual të rendimenteve në shumën reale ndaj rendimenteve në shumën nominale, ndërsa në periudhën pas vitit 2019 (veçanërisht në vitin 2022) shënoi rritje që ndikon në largimin gradual të rendimenteve në shumën reale nga rendimentet në shumën nominale.

Kontributi shtatëvjeçar në nivelin e sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital për periudhën 31.12.2016 – 31.12.2024, të llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar²¹ të njësive të kontabilitetit të fondeve të detyrueshme pensionale, të reduktuar në nivel vjetor është 4,03% në shumën nominale, përkatësisht 0,16% në shumën reale.

5.7 Kompensimet tek fondet e detyrueshme pensionale

Për kryerjen e funksioneve të tij të menaxhimit të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, vlerësimit të mjeteve, anëtarësimit, mbajtjes së llogarive individuale të anëtarëve dhe njoftimit të anëtarëve, si dhe për pagesën e kompensimeve për MAPAS-in, për Fondin e SPIMV-së dhe për kujdestarin e pronës dhe mbulimin e shpenzimeve të veta, shoqëritë, në përputhje me Ligjin, arkëtojnë kompensim të kontributeve, kompensim të mjeteve dhe kompensim për transferim.

Mënyra e tillë e financimit të shoqërive pensionale është e zakonshme për shoqëritë që funksionojnë në sistemin pensional të ngjashëm me sistemin pensional të Maqedonisë. Kompensimi që arkëtohet si përqindje e kontributeve, paguhet një herë nga pagesa e kontributit dhe më pas ai kontribut investohet deri në tërheqjen e mjeteve apo fondeve, ndërsa kompensimi që arkëtohet nga mjetet, arkëtohet në fund të çdo muaji, nga fondet e përgjithshme të cilat menaxhohen. Kompensimet e bazuara në kontribute, kanë peshë “në fillim”, përkatësisht janë relativisht të mëdha në vitet fillestare. Kompensimet e bazuara në mjete kanë peshë “në fund”, pasi mjetet e akumuluar janë shumë më të mëdha në vitet sa më afër daljes në pension²². Shikuar në një afat të gjatë, kompensimi i kontributeve nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në lartësinë e pensionit të anëtarit, ndërsa kompensimi i mjeteve do të bëhet më i rëndësishëm me kalimin e viteve.

Llojet dhe vlerat e tarifave që arkëtohen nga kompanitë që menaxhojnë fondet e detyrueshme pensionale në vitin 2024 janë pasqyruar në Tabelën 5.9.

Fillimisht, kompensimi i kontributeve ishte përcaktuar në tender, ndërsa kompensimi i parë që e arkëtuan SAVA dhe KB Prvo ishte 8,50%. Më tej, me zhvillimin e sistemit dhe me zvogëlimin e kompensimeve që i arkëtojnë institucionet shtetërore nga shoqëritë, si dhe me rritjen e kontributeve dhe mjeteve, të cilat janë bazë për llogaritjen e kompensimeve, pasoi zvogëlimi i vazhdueshëm gradual i këtij kompensimi. Lartësia e kompensimeve të kontributeve, të cilat u arkëtuan nga fillimi i ekzistimit të sistemit, deri në vitin 2024, është paraqitur në Tabelën 5.10.

Kompensimi i mjeteve ishte përcaktuar me ligj dhe, përfundimisht në maj të vitit 2013 ishte 0,05% në muaj nga vlera e mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional, ndërkohë përfundimisht në dhjetor të vitit 2014 ishte 0,045%. Nga janari i vitit 2015, kompensimi ishte 0,04%, përfundimisht me muajin dhjetor të vitit 2016. Nga janari i vitit 2017, kompensimi i mjeteve ishte 0,035%. Nga janari 2019 kompensimi i mjeteve ishte 0,030%.

Nga viti 2013, me ligj ishte përcaktuar lartësia maksimale e kompensimit të kontributeve dhe kompensimit të mjeteve, që do të mund ta arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe ishte parashikuar zvogëlimi i mëtejshëm i tyre gradual. Në vitin 2024, të gjitha shoqëritë pensionale ulën masën e kompensimit nga kontributet nga 1,90% në 1,80% të kontributeve të paguara në fondet e detyrueshme pensionale.

Arkëtimi i kompensimeve (në milionë denarë) nga shoqëritë gjatë vitit 2024 është pasqyruar në Tabelën 5.15

Provizionet e transaksionit, në lidhje me transaksionet për fitimin ose për transferimin e mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional, paguhet nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional për personat juridikë të përzgjedhur që ofrojnë shërbime me letrat me vlerë, brenda dhe jashtë vendit. Provizionet e transaksionit llogariten si përqindje e vlerës së çdo transaksioni të lidhur.

Gjatë vitit 2024, nga SAVAd ishin arkëtuar gjithsej 3,63 milionë denarë provizione të transaksionit, nga KBPd ishin arkëtuar gjithsej 1,21 milionë denarë dhe nga TRIGLAVd ishin arkëtuar gjithsej 0,25 milionë denarë provizione të transaksionit.

²¹ Vlera mesatare llogaritet si mesatare e ponderuar e njësive kontabël të fondeve të detyrueshme pensionale në raport me mjetet neto të fondeve të detyrueshme pensionale.

²² Administrative Charges for Funded Pensions: An International Comparison and Assessment, Edward Whitehouse, June 2000

Tabela 5.13. Kompensimet të cilat i arkëtuan shoqëritë që menaxhojnë fondet e detyrueshme pensionale në vitin 2023

Lloji kompensimit	SAVA	KB e Para	TRIGLAV****
Kompensim nga kontributet	1,90%*	1,90%*	1,90%
Kompensim mujor nga vlera e mjeteve neto në fondin pensional të detyrueshëm	0,030%**	0,030%**	0,030%
Kompensim per transfer			
Nr i diteve****	Shuma e kompensimit për transfer	Shuma e kompensimit për transfer	Shuma e kompensimit për transfer
Nr i diteve ≤ 720	15 euro	15 euro	15 euro
Nr i diteve > 720	Nuk paguhet kompensim për transfer	Nuk paguhet kompensim për transfer	Nuk paguhet kompensim për transfer

* Maksimumi ligjor për vitin 2023 është 2.00% (Shuma më parë ishte 2.00% për të gjitha FDP-të).

** Lartësia është e barabartë me maksimumin e përcaktuar ligjërisht për vitin 2019 (paraprakisht ishte 0,035% edhe te SAVAd, edhe te KBPd).

*** Lartësia është e barabartë me maksimumin e përcaktuar ligjërisht për vitin 2019. (Nga prilli vitit 2019).

**** Numri i ditëve llogaritet nga data për të cilën anëtar i ka fituar statusin e anëtarit në fondin ekzistues të detyrueshëm pensional (ose nga dita e parë e muajit për të cilin anëtar i ka fituar të drejtën e kontributit në fondin ekzistues të detyrueshëm pensional, në rastin e anëtarësimit të parë) deri në datën e transferimit të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional.

Tabela 5.14. Lartësia e kompensimeve të kontributeve që i arkëtojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e dytë

	shuma	Data e zbatimit		shuma	Data e zbatimit		shuma	Data e zbatimit
SAVA	9,90%	Në tender	KB e Para	9,90%	Në tender	TRIGLAV	2,25%	Nga prill, 2019
	8,50%	Nga fillimi i sistemit (2006)		8,50%	Nga fillimi i sistemit (2006)		2,00%	Nga janari, 2020
	7,90%	Nga korriku, 2007		7,90%	Nga korriku, 2007		1,90%	Nga janari, 2023
	6,90%	Nga shkurti, 2008		6,80%	Nga shkurti, 2008			
	6,50%	Nga maji, 2009		5,50%	Nga janari, 2010			
	5,50%	Nga janari, 2010		4,50%	Nga janari, 2011			
	4,50%	Nga janari, 2011		4,00%	Nga janari, 2012			
	4,00%	Nga janari, 2012		3,75%	Nga qershori, 2013			
	3,75%	Nga qershori, 2013		3,50%	Nga janari, 2014			
	3,50%	Nga janari, 2014		3,25%	Nga janari, 2015			
	3,25%	Nga janari, 2015		3,00%	Nga janari, 2016			
	3,00%	Nga janari, 2016		2,75%	Nga janari, 2017			
	2,75%	Nga janari, 2017		2,50%	Nga janari, 2018			
	2,50%	Nga janari, 2018		2,25%	Nga janari, 2019			
	2,25%	Nga janari, 2019		2,00%	Nga janari, 2020			
	2,00%	Nga janari, 2020		1,90%	Nga janari, 2023			
	1,90%	Nga janari, 2023						

Kompensimi i mjeteve ishte përcaktuar me ligj dhe, përfundimisht në maj 2013 ishte 0,05% në muaj nga vlera e mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional, pastaj përfundimisht në dhjetor 2014 ishte 0,045%. Në janar 2015, kompensimi ishte 0,04%, përfundimisht me muajin dhjetor 2016. Në janar 2017, kompensimi i mjeteve ishte 0,035%. Nga janari 2019 kompensimi i mjeteve ishte 0,030%.

Nga viti 2013, me ligj ishte përcaktuar lartësia maksimale e kompensimit të kontributeve dhe kompensimit të mjeteve, që do të mund ta arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe ishte parashikuar zvogëlimi i mëtejshëm i tyre gradual. Në vitin 2023, të gjitha shoqëritë pensionale ulën masën e kompensimit nga kontributet nga 2.00% në 1.90% të kontributeve të paguara në fondet e detyrueshme pensionale.

Arkëtimi i kompensimeve (në milionë denarë) nga shoqëritë gjatë vitit 2023 është paraqitur në Tabelën 5.15.

Tabela 5.15. Arkëtimi i kompensimeve nga shoqëritë gjatë vitit 2023

(në milionë denarë)

	Jan.	Shku.	Mar.	Prill.	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shat.	Tet.	Nen.	Dhje.	Toatli
SAVAd – totali	22,95	25,59	24,82	24,59	24,83	26,88	26,11	26,51	26,04	26,80	26,68	28,67	310,46
Nga kontributet	7,46	9,80	8,95	8,50	8,56	10,30	9,33	9,66	9,01	9,73	9,38	10,93	111,61
Nga mjetet	15,49	15,79	15,87	16,08	16,27	16,58	16,78	16,85	17,03	17,06	17,30	17,74	198,85
KBPd-totali	25,62	28,35	27,49	27,25	27,49	29,67	28,91	28,91	28,94	29,65	29,83	31,76	343,89
Nga kontributet	8,13	10,56	9,66	9,20	9,23	11,08	10,09	9,96	9,79	10,47	10,35	11,86	120,39
Nga mjetet	17,49	17,79	17,83	18,05	18,25	18,59	18,83	18,95	19,16	19,19	19,47	19,90	223,51
TRIGLAVd-totali	3,05	3,58	3,59	3,64	3,82	4,22	4,10	4,35	4,34	4,56	4,65	5,04	48,95
Nga kontributet	1,37	1,80	1,73	1,69	1,77	2,09	1,91	2,09	2,00	2,16	2,16	2,44	23,22
Nga mjetet	1,68	1,78	1,86	1,96	2,05	2,13	2,19	2,26	2,34	2,40	2,49	2,60	25,72

Provizionet e transaksionit, në lidhje me transaksionet për fitimin ose për transferimin e mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional, paguhet nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional për personat juridikë të përzgjedhur që ofrojnë shërbime me letrat me vlerë, brenda dhe jashtë vendit. Provizionet e transaksionit llogariten si përqindje e vlerës së çdo transaksioni të lidhur.

Gjatë vitit 2023, nga SAVAd ishin arkëtuar gjithsej 1,18 milionë denarë provizione të transaksionit, nga KBPd ishin arkëtuar gjithsej 0,93 milionë denarë dhe nga TRIGLAVd ishin arkëtuar gjithsej 0,28 milionë denarë provizione të transaksionit.

5.8 Pagesa e pensioneve nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital

Kushtet për fitimin e së drejtës së pensionit janë të njëjta edhe për shtyllën e parë edhe për shtyllën e dytë: kufiri i moshës 64 vjeç për meshkujt, përkatësisht 62 vjeç për femrat, me minimum 15 vjet stazh pune.

Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit familjar dhe pensionit invalidor, si dhe nga pensioni minimal. Pensioni nga shtylla e parë llogaritet si pension i përkufizuar sipas formulës së caktuar paraprakisht (përqindja e caktuar, në varësi të viteve të stazhit, të shumëzuar me bazën pensionale, të përcaktuar me rroga të valorizuara për gjithë kohëzgjatjen e punës).

Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, në formën e zgjedhur nga anëtarit:

- anuiteti pensional me të gjithë shumën e mjeteve, të akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit; anuiteti paguhet deri në fund të jetës, nga shoqëria e sigurimit, e autorizuar për këtë qëllim, ose
- tërheqjet e programuara, nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit dhe paguhet nga shoqëria që e menaxhon fondin e detyrueshëm pensional, ose
- kombinimi i metodave të lartpërmendura.

Sigurimi i anuiteteve pensionale dhe tërheqjeve të programuara rregullohet me Ligjin për Pagesën e Pensioneve dhe Kompensimeve të Pensioneve nga Sigurimi Pensional me Financim Kapital.

Nëse i siguruari i cili e ka realizuar të drejtën e pensionit invalidor është anëtar i shtyllës së dytë, shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë e këtij anëtar transferohet në Fondin e SPIMV-së dhe pagesa e plotë e pensionit invalidor paguhet nga Fondi i SPIMV-së. Me përjashtim, nëse mjetet e akumuluar në llogarinë e anëtarit janë më shumë se shuma e nevojshme për pagesën e pensionit invalidor, në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, atëherë anëtarit mund të zgjedhë në vend të atij pensioni të marrë pensionin e shtyllës së dytë.

Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional të shtyllës së dytë, anëtarët e të cilit kanë të drejtën e pensionit familjar, shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë e këtij anëtar transferohet në Fondin e SPIMV-së dhe pagesa e plotë e pensionit familjar paguhet nga Fondi i SPIMV-së. Me përjashtim, nëse mjetet e akumuluar në llogarinë e anëtarit janë më shumë se shuma e nevojshme për pagesën e pensionit familjar, në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, atëherë përdoruesi i pensionit familjar mund të zgjedhë, në vend të atij pensioni, të marrë pensionin e shtyllës së dytë.

Në vitin 2024 ishin realizuar 122 pensione invalidore dhe 329 pensione familjare nga anëtarët e shtyllës së dytë, përkatësisht anëtarët e familjes së anëtarit të vdekur, për çka mjetet e akumuluaru të tyre ishin transferuar në Fondin e SPIMV-së, nga ku paguhet pensioni invalidor, përkatësisht pensioni familjar. Në vitin 2024, për 35 anëtarë të shtyllës së dytë filloi të paguhet pensioni i pleqërisë nga shtylla e dytë, nëpërmjet tërheqjeve të programuara. Gjithashtu, në vitin 2024 nisën t'i paguheshin tërheqjet e përkohshme të programuara një familjari të një anëtarit të ndjerë që kishte të drejtë për pension familjar. Ndërsa në vitin 2024, u pagua pensioni i pleqërisë nga shtylla e dytë nëpërmjet tërheqjeve të programuara, për gjithsej 71 anëtarë të pensionuar (duke i përfshirë anëtarët që filluan t'i tërheqin mjetet në vitet paraprake) dhe iu paguan tërheqjet e programuara të përkohshme anëtarëve të familjes së tre anëtarëve të ndjerë të cilët kishin të drejtë për pension familjar.

Parashihen edhe raste në të cilat bëhet pagesa e mjeteve të llogarisë individuale të anëtarit, dhe më pas mos të realizojë të drejtën e pensionit, si:

- kur anëtar i ndjerë i fondit të detyrueshëm pensional nuk ka anëtarë të familjes të cilët kanë të drejtën e pensionit familjar, atëherë mjetet në llogarinë e atij anëtar bëhen pjesë e trashëgimisë së trashëgimtarit dhe me to veprohet në përputhje me Ligjin për Trashëgimi;
- kur anëtar i fondit të detyrueshëm pensional nuk do ta fitojë të drejtën e pensionit të pleqërisë sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, për shkak se nuk ka stazh të pensionit të paktën 15 vjet, mund të marrë pensionin vetëm nga mjetet e shtyllës së dytë, nëse pensioni është më i madh ose i barabartë me 40% të shumës më të ulët të pensionit dhe nëse shuma e llogaritur e pensionit është më e vogël se 40% e shumës më të ulët të pensionit, fondi i detyrueshëm pensional anëtarit menjëherë do t'ia paguajë mjetet e akumuluaru në llogarinë e tij. Realizimi i pensionit vetëm nga mjetet e shtyllës së dytë dhe pagesa e gjithsej mjeteve të akumuluaru në këto raste mund të bëhet pas mbushjes së moshës 65 vjeçare.

Gjatë vitit 2024 ishin paguar mjete si trashëgimi nga llogaritë individuale për 123 anëtarë të ndjerë. Gjithashtu, iu paguan mjete vetëm një herë (të njëherëshme) 6 personave.


Një pasqyrë më e detajuar e pensioneve dhe pagesave të realizuara për anëtarët e shtyllës së dytë në vitin 2024, sipas fondeve të detyrueshme pensionale, është dhënë në Tabelën 5.12

Tabela 5.12. Pensionet dhe pagesat e realizuara për anëtarët në shtyllën e dytë në vitin 2024

Lloji i pensionit dhe pagesës / Fondi i detyruar pensional	SAVAd	KBPd	TRIGLAVd	Totali
Pensioni invalidor	48	46	4	98
Pensioni familjar	95	94	9	198
Pensioni i pleqërisë – tërheqjet e programuara	7	11	0	18
Pensioni familjar – tërheqjet e programuara	1	0	0	1
Pagesa e njëherëshme – anëtar	1	3	0	4
Pagesa e njëherëshme – trashëgimia	59	41	2	102
Gjithsej	211	195	15	421

Në Grafikun 5.27. është paraqitur struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e dytë, në shtatëmbëdhjetë vitet e ekzistimit të shtyllës së dytë, përfshirë edhe vitin 2024. Numri i pagesave është shumë i vogël, sepse anëtarët janë të rinj. Pjesa më e madhe e pagesave janë në rastet e vdekjes së anëtarit, përmes realizimit të pensionit familjar, ose pagesës së trashëgimisë, pastaj pagesat në bazë të realizimit të pensionit invalidor, ndërsa më i vogël është numri i pagesave të njëherëshme për anëtarët dhe pagesave për anëtarët përmes tërheqjeve të programuara.

Grafiku 5.27. Struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e dytë që nga fillimi i sistemit



6 Informacione për fondet vullnetare pensionale

- 6.1 Qëllimi i sigurimit vullnetar pensional me financim kapital
- 6.2 Anëtarësimi në fondet vullnetare pensionale
- 6.3 Transferimi i anëtarit nga njëra llogari në tjetrën në të njëjtin fond ose në një fond tjetër vullnetar pensional
- 6.4 Kontributet në fondet vullnetare pensionale
- 6.5 Investimi dhe struktura e portfolit të fondeve pensionale vullnetare
- 6.6 Mjetet neto, njësia kontabël dhe norma e rendimentit të fondeve pensionale vullnetare
- 6.7 Kompensimet në fondet vullnetare pensionale
- 6.8 Pagesa e kompensimeve pensionale nga sigurimi vullnetar pensional me financim kapital

6. Informacione për fondet vullnetare pensionale

Në financimin kapital të sigurimit vullnetar pensional, deri në fund të vitit 2024 ka gjithsej 33.572 anëtarë, që nënkupton një rritje të anëtarësisë gjatë vitit prej 6,58%, që është përafërsisht në të njëjtin nivel si vitin e kaluar. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve në shtyllën e tretë, rreth 51% janë anëtarë me llogari vullnetare individuale, ndërsa rreth 49% janë pjesëmarrës në një skemë pensionale me llogari profesionale. Fondi i ri pensional vullnetar solli një lëvizje disi më të madhe në kalimet e anëtarëve nga një fond pensional vullnetar në një tjetër edhe në vitin 2024.

Gjatë vitit 2024, në fondet vullnetare pensionale janë paguar gjithsej rreth 533,92 milionë denarë. Mjetet e përgjithshme të fondeve vullnetare pensionale shënuan një rritje më të madhe në krahasim me mjetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale, përkatësisht u rritën për 21,74% dhe arritën në 4,36 miliardë denarë, që përfaqëson rreth 0,46% të BPV-së së RMV-së. Në strukturën e portofolit investues të fondeve pensionale vullnetare vërehet një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së investimeve të huaja, kryesisht për shkak të rritjes së pjesëmarrjes në obligacionet shtetërore të huaja. Portofoli investues për vitin 2024 përbëhet nga investime vendore që përfshijnë letra me vlerë shtetërore (55,76%), depozita (4,90%), aksione (5,96%) dhe një pjesë shumë të vogël në fonde investuese (1,25%); si dhe investime të huaja që përfshijnë obligacione shtetërore të huaja (2,65%), obligacione korporative (0,16%), pjesëmarrje në fonde investuese (24,12%) dhe aksione (4,45%).

Në vitin 2024, vlerat e njësive llogaritëse të katër fondeve vullnetare pensionale shënuan përsëri rritje, pas devijimit nga trendi i rritjes në vitin 2022 (10,45% për SAVAv, 9,47% për KBPv, 9,43% për TRIGLAVv dhe 14,55% për VFPv). Në lidhje me kthimin e fondeve pensionale, në vitin 2024 është vërejtur një rritje e vogël e kthimit si në shumën nominale, ashtu edhe në atë reale, për periudhën shtatëvjeçare 2018 - 2024, si për fondet e detyrueshme ashtu edhe për fondet vullnetare pensionale. Megjithatë, rritja e ndryshimit të nivelit të kostos së jetesës, e llogaritur në nivel vjetor, ndikon ende dukshëm mbi shumën e të ardhurave në vlerën reale edhe në vitin 2024. Në shtyllën e tretë, për periudhën 2018 - 2024 u realizua një kthim mesatar vjetor prej 5,33% në shumë nominale, përkatësisht 0,44% në shumë reale, i llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive kontabël të fondeve vullnetare pensionale.

Në vitin 2024 janë realizuar 332 kompensime pensionale dhe pagesa në shtyllën e tretë.

6.1 Qëllimi i sigurimit vullnetar pensional me financim kapital

Qëllimi primar i sigurimit vullnetar pensional me financim kapital është sigurimi i të ardhurave më të larta pas daljes në pension, për personat e siguruar që tashmë janë të siguruar në sistemin pensional me një shtyllë dhe/ose me dy shtylla, për të siguruar pension për personat që nuk janë të përfshirë nga sigurimi i detyrueshëm pensional personalisht për veten ose nga personat e tjerë dhe sigurimin e parakushteve për vendosjen e skemave pensionale profesionale në procesin e harmonizimit të sistemit të sigurimit social në RMV me sistemet e BE-së. Parimet themelore të sigurimit vullnetar pensional me financim kapital janë: sigurimi i fondeve shtesë në rast të pleqërisë, anëtarësimi në bazë vullnetare, financimi kapital në parimin e kontributeve të përcaktuara, investimi i fondeve në bazë të sigurisë, diversifikimi i rrezikut dhe mbajtja e likuiditetit adekuat, si dhe transparenca.

Sigurimi vullnetar pensional mundëson mbulimin e një grupi të madh personash nga popullsia e RMV-së, si dhe të personave që nuk janë shtetas të RMV-së. Kjo mundëson kursimin shtesë për pleqërinë, gjë që rrit sigurinë materiale në pleqëri. Për më tepër, në përputhje me praktikën e zakonshme në shumë vende evropiane, ku ekzistojnë skemat pensionale profesionale, përmes të cilave punëdhënësit, ose shoqatat e qytetarëve, organizojnë dhe financojnë sigurim pensional shtesë për të punësuarit e tyre, përkatësisht anëtarët, kjo është e mundur edhe në RMV. Meqë sistemet evropiane të sigurimit social janë nën presion, që vazhdimisht rritet, pensionet profesionale në të ardhmen do të luajnë gjithnjë e më shumë rol në plotësimin e të ardhurave pas daljes në pension.

Për këto shkaqe, duhet të zhvillohen pensionet profesionale, në mënyrë suplementare të sigurimit social, me qëllim të ofrimit të sigurimit të sigurt, të përhershëm dhe efikas social, që duhet të garantojë standard të mirë jetësor në pleqëri. Në shtyllën e tretë, punëdhënësi, ose shoqata e qytetarëve (siguruesi), mund të organizojë dhe të financojë skemën pensionale profesionale dhe të paguajë kontribut në fondin vullnetar pensional për të punësuarit dhe anëtarët e tij. Një pjesë e mire e punëdhënësve, ose disa shoqata të qytetarëve, mund të organizojnë dhe të financojnë së bashku skema pensionale profesionale. Siguruesi nënshkruan kontratë me shoqërinë që ka zgjedhur për të menaxhuar fondin vullnetar pensional, ku do të përfshihet edhe skema pensionale profesionale.

Pritet që sigurimi vullnetar pensional me financim kapital të ketë ndikim të rëndësishëm shtesë në ekonominë në tërësi, nëpërmjet rritjes së kursimit të popullsisë, rritjes së fuqisë së investimit dhe nxitjes së zhvillimit dhe thellimit të tregut të kapitalit, nëpërmjet investimit të mjeteve në fondet vullnetare pensionale, rritjes së kërkesave për instrumente të reja dhe nëpërmjet shërbimeve të reja financiare, etj.

Sigurimi vullnetar pensional me financim kapital u bë operativ në gjysmën e dytë të vitit 2009, ashtu që shoqërive ekzistuese u janë dhënë lejet për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale. Fondi i hapur vullnetar pensional “NLB Penzija Plus” - Shkup filloi me punë më 15.7.2009, ndërsa KB e Para Fondi i parë i hapur vullnetar pensional - Shkup, më 21.12.2009. Në qershor 2018, MAPAS dha leje për ndryshimin e emrit të fondit pensional Fondi i hapur vullnetar pensional – “NLB Penzija Plus” Shkup në Fondin e hapur vullnetar pensional Sava Penzija Plus. TRIGLAV Fondi i hapur vullnetar pensional – Shkup filloi me punë më 1.3.2021. VFP Fondi i hapur vullnetar pensional - Shkup filloi me punë më 18.10.2022.

6.2 Anëtarësimi në fondet vullnetare pensionale

Një person mund të bëhet anëtar në fondin pensional vullnetar në tri mënyra:


- 1) me nënshkrimin e kontratës për anëtarësim në fondin vullnetar pensional ndërmjet personit dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare,
- 2) me nënshkrimin e kontratës për anëtarësim në fondin vullnetar pensional ndërmjet personit, personit fizik që paguan në emër dhe për llogari të personit (paguesit) dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare,
- 3) me pjesëmarrjen në skemën pensionale profesionale, të organizuar nga punëdhënësi i tij ose nga shoqata në të cilën është anëtar dhe me hapjen e llogarisë profesionale.

Një person mund të ketë vetëm një llogari individuale vullnetare dhe një llogari profesionale. Këto llogari mund të jenë në të njëjtin fond ose në fondin e ndryshëm vullnetar pensional.

Në sigurimin vullnetar pensional me financim kapital, me bilancin më 31.12.2024 ka gjithsej 33.572 anëtarë, që do të thotë 2.072 anëtarë më shumë krahasuar me bilancin e 31.12.2023, përkatësisht ka rritje të anëtarësimit prej rreth 6,58%. Rritja e anëtarësimit në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 e mban afërsisht të njëjtin nivel si edhe vitin e kaluar. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve në shtyllën e tretë 17.040 ose rreth 51% janë anëtarë me llogari individuale vullnetare, ndërsa 16.532 ose rreth 49% janë pjesëmarrës në skemën pensionale me llogari profesionale. Meqë TRIGLAVv dhe VFPv kanë numër relativisht të vogël anëtarësh (0,59% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në TRIGLAVv dhe 1.36% në VFPv), në raport me shpërndarjen e anëtarëve sipas fondeve vullnetare pensionale, deri më 31.12.2024, nuk ka ndryshim të rëndësishëm në fondet e vullnetare pensionale që funksionojnë që nga viti 2009 në krahasim me situatën e vitit të kaluar, pra rreth 45,11% e anëtarëve janë në SAVAv, ndërsa rreth 52.51% janë në KBPv.

Nga Grafiku 6.1, ku është pasqyruar struktura e anëtarëve sipas fondeve vullnetare pensionale dhe sipas llojit të anëtarësimit, në vitin 2024, në nivel tremujor, mund të vërehet dallimi evident për sa i përket llojit të anëtarësimit në të katër fondet vullnetare pensionale. Sa i përket strukturës së anëtarëve sipas llojeve deri më 31.12.2024, nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm në SAVAv dhe KBPv krahasuar me situatën e vitit të kaluar. Gjegjësisht, SAVAv ka një numër më të madh të anëtarëve me llogari individuale vullnetare (68.74%), ndërsa KBPv ka më shumë anëtarë në skemat pensionale me llogari profesionale (65.02%). Sa i përket strukturës së anëtarëve sipas llojeve deri më 31.12.2024 në TRIGLAVv ka një ndryshim më të madh në krahasim me situatën e vitit të kaluar dhe në fund të 2024 në TRIGLAVv ka një numër më të madh me llogari individuale vullnetare (69.54%). Gjithashtu nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm edhe në VFPv në krahasim me situatën e vitit të kaluar dhe shpërndarja e anëtarësimit është më e barabartë, megjithëse shumica janë anëtarë me llogari individuale vullnetare (54.06%).


Grafiku 6.1. Struktura e anëtarëve sipas FVP-së edhe sipas llojit të anëtarësimit



Nga përvoja e deritanishme, zakonisht, anëtarët që kanë llogari individuale vetë i paguajnë mjetet, ndërsa në një numër të vogël rastesh ka anëtarë për të cilët kontribut pagan paguesi (nga gjithsej 17.040 anëtarë që kanë llogari individuale, vetëm 955 anëtarë ose 5,62% kanë pagues). Sigurimi vullnetar pensional me financim kapital mundëson anëtarësimin e personave që nuk janë shtetas të RMV-së. Në ekzistimin e deritanishëm të shtyllës së tretë ka shumë pak anëtarë që janë shtetas të huaj (0,01% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve).


Lidhur me pjesëmarrjen e anëtarëve në skemat pensionale profesionale, në SAVAv, 4.734 anëtarë janë pjesëmarrës në 1.240 skema pensionale profesionale, në KBPv, 11.461 anëtarë janë pjesëmarrës në 2.853 skema pensionale profesionale, në TRIGLAVv, 60 anëtarë janë pjesëmarrës në 5 skemat pensionale profesionale dhe në VFPv, 277 anëtarë janë pjesëmarrës në 67 skemat pensionale profesionale. Ekzistojnë skema pensionale profesionale me disa dhjetëra anëtarë dhe skema pensionale profesionale vetëm me 1 deri në 2 anëtarë. Nga numri i përgjithshëm i skemave, 21 skemat pensionale profesionale kanë mbi 100 anëtarë, katër skema kanë mbi 500 anëtarë, njëra prej të cilave ka mbi 1.000 anëtarë. Sistemi i anëtarëve në skemat pensionale profesionale sipas fondeve është dhënë në Grafikon 6.2., ku në mënyrë të veçantë janë paraqitur vetëm skemat që kanë më shumë se 100 anëtarë, ndërsa pjesa tjetër e skemave përfshihen në zërin "të tjera".

Grafiku 6.2. Sistemi i anëtarëve në shtyllën e tretë në skemat pensionale profesionale



Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë, sipas moshës, gjinisë dhe llojit të anëtarësimit, është pasqyruar në Grafikon 6.3.


Grafiku 6.3. Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë sipas moshës, gjinisë dhe llojit të anëtarësimit



Nga kjo pasqyrë grafike mund të vërehet se në shtyllën e tretë në krahasim me shtyllën e dytë ka më shumë anëtarë më të vjetër. Diçka rreth 57% e anëtarëve me llogari individuale vullnetare janë të moshës deri në 45 vjeç, ndërsa rreth 55% e anëtarëve me llogari profesionale janë të moshës deri në 50 vjeç. Anëtarët që kanë llogari profesionale janë më të vjetër se anëtarët me llogari individuale. Mosha mesatare e anëtarëve me llogari individuale është 45 vjeç për burra dhe 44 vjeç për gra, ndërsa mosha mesatare e anëtarëve me llogari profesionale është 50 vjeç për burra dhe gra, kurse mosha mesatare e të gjithë anëtarëve gjithsej është 47 vjeç.


Pjesëmarrja e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të shtyllës së tretë në popullsinë e përgjithshme të aftë për punë dhe në popullsinë e përgjithshme aktive ndonëse u rrit në vitin 2024 akoma është e vogël. Me gjendjen në fund të vitit 2024, vetëm rreth 2,2% e popullsisë së përgjithshme të aftë për punë në RMV janë anëtarë të shtyllës së tretë, përkatësisht rreth 4,2% e popullsisë së përgjithshme aktive në RMV janë anëtarë të shtyllës së tretë. Rritja e pjesëmarrjes së anëtarëve në shtyllën e tretë, në popullsinë e përgjithshme të aftë për punë dhe popullsinë aktive në RMV, në periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2024, është paraqitur në Grafikon 6.4. Ky rezultat tregon se ekziston potencial i konsiderueshëm për zhvillimin e shtyllës së tretë.

Grafiku 6.4. Pjesëmarrja e anëtarëve në shtyllën e tretë në popullsinë e përgjithshme të aftë për punë dhe popullsinë aktive, sipas viteve, 2017-2024



Struktura e anëtarëve në fondet e pensioneve vullnetare sipas rajoneve statistikore²³ në RMV është dhënë në Grafikon 6.5.

Grafiku 6.5. Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë, sipas rajoneve statistikore



²³ Rajonet statistikore përcaktohen sipas Entit Shtetëror të Statistikës - njësi territoriale. Nomenklatura e njësive territoriale bazohet në organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në RSM dhe është e harmonizuar me klasifikimin e BE-së.

Më së shumti anëtarë në katër fondet vullnetare pensionale ka nga Rajoni i Shkupit, 7.389 anëtarë në KBPv, 6.256 anëtarë në SAVAv, 392 anëtarë në VFPv dhe 140 anëtarë në TRIGLAVv. Më së paku anëtarë në SAVAv ka nga Rajoni i Pollogut (812 anëtarë), më së paku anëtarë në KBPv ka nga Rajoni Juglindor (882 anëtarë), më së paku anëtarë në TRIGLAVv ka nga Rajoni Verilindor (1 anëtar), ndërsa më së paku anëtarë në VFP ka nga Rajoni i Pellagonisë (14 anëtarë).

6.3 *Transferimi i anëtarit nga njëra llogari në tjetrën në të njëjtin fond ose në një fond tjetër vullnetar pensional*

Personat kanë të drejtën e zgjedhjes së fondit vullnetar pensional dhe të drejtën e ndryshimit të fondit të zgjedhur vullnetar pensional, sipas dëshirës të tyre, në çdo kohë. Nëse anëtari është anëtar i fondit ekzistues vullnetar pensional më shkurt se 12 muaj, gjatë transferimit duhet të paguajë kompensimin për transferim. Përndryshe, transferimi është falas. Gjatë transferimit transferohen edhe fondet e përgjithshme nga llogaria e anëtarit. Gjithashtu, në rast transferimi të pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale nga njëri sigurues në tjetrin, ai ka të drejtën e transferimit të mjeteve të kursyera në skemën profesionale në llogarinë profesionale ose në llogarinë individuale vullnetare, nëse siguruesi tjetër nuk ka organizuar skemë pensionale profesionale ose nuk e përfshin edhe personin në të. Anëtari, i cili është pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale, ka të drejtën e transferimit të fondeve në llogarinë individuale vullnetare, nëse nuk punësohet ose nuk anëtarësohet në shoqatën e qytetarëve.

Në Tabelën 6.1. janë dhënë të dhënat për numrin e anëtarëve që janë transferuar nga njëri fond vullnetar pensional në tjetrin dhe për shumën e mjeteve të transferuara nga njëri fond vullnetar pensional në tjetrin, mbi këtë bazë, gjatë vitit 2024.

Tabela 6.1. Transferimi i anëtarit nga njëri fond në një fond tjetër vullnetar pensional

2024		FPV-ja në të cilën janë transferuar anëtarët, përkatësisht në të cilën janë bartur mjetet				Totali
		SAVAv	KBPv	TRIGLAVv	VFPv	
Anëtarët që janë transferuar nga FVP	SAVAv	-	31	3	32	66
	KBPv	41	-	0	60	101
	TRIGLAVv	1	1	-	1	3
	VFPv	2	7	0	-	9
	Gjithsej	44	39	3	93	179
Mjetet e transferuara nga FPV (në denarë)	SAVAv	-	8.842.219	4.302.949	18.133.064	31.278.232
	KBPv	13.705.776	-	0	34.492.958	48.198.734
	TRIGLAVv	40.262	44.963	-	130.217	215.442
	VFPv	661.694	263.503	0	-	925.197
	Gjithsej	14,407,732	9,150,685	4,302,949	52,756,239	80,617,605

Fillimi me punë i fondit të katërt vullnetar pensional VFP ka shkaktuar lëvizje disi më të madhe në transferimet e anëtarëve nga njëri fond vullnetar pensional në tjetrin në vitin 2022 dhe 2023. Sidoqoftë në vitin 2024, numri i anëtarëve që kanë bërë ndryshim në fondin vullnetar pensional mbetet pothuajse në të njëjtin nivel në krahasim me vitin paraprak dhe rezultojnë 179, që paraqet 0,53% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Kështu, 42 anëtarë kanë kaluar në SAVAv, 32 kanë kaluar në KBPv, 3 anëtarë kanë kaluar në TRIGLAVv dhe 93 kanë kaluar në VFPv. Gjatë transferimit, rreth 13,75 milionë denarë janë transferuar në SAVAv, rreth 8,89 milionë denarë janë transferuar në KBPv, 4,30 milionë denarë janë transferuar në TRIGLAVv dhe rreth 52,76 milionë denarë janë transferuar në VFPv. Gjithashtu, në vitin 2024 ka pasur transferime brenda të njëjtit fond pensional nga njëra skemë profesionale në tjetrën dhe nga llogaria profesionale në llogarinë individuale vullnetare.

6.4 Kontributet në fondet vullnetare pensionale

Pagesa e kontributit vullnetar mund të bëhet vetëm për personin që i përmbush kushtet për anëtarësim në fondin vullnetar pensional, në përputhje me Ligjin për Sigurim Vullnetar Pensional me Financim Kapital. Pagesa e kontributit vullnetar, në emër dhe për llogari të anëtarit që ka llogari individuale vullnetare, mund të bëhet nga anëtari dhe/ose paguesi. Pagesën e kontributit vullnetar, në emër dhe për llogari të anëtarit që ka llogari profesionale, mund ta kryejë vetëm siguruesi. Pagesat bëhen nga llogaria e transaksionit të anëtarit dhe/ose paguesit ose siguruesit. Kontributi vullnetar paguhet në llogari të veçantë në para të fondit vullnetar, e cila mbahet pranë kujdestarit të pronës dhe shpërndahet në llogarinë individuale vullnetare, ose në llogarinë profesionale të anëtarit, në varësi të mënyrës së anëtarësimit dhe pas përmbushjes së kushteve për anëtarësim.

Anëtari, paguesi dhe siguruesi kanë të drejtë të përcaktojnë lirisht lartësinë e shumës së paguar të kontributit vullnetar dhe dinamikën e pagesës, ndërsa ndryshimi i lartësisë së pagesës, ose ndërprerja e pagesës, nuk ndikojnë në të drejtën e anëtarësimit në fond, përkatësisht nuk do të thotë ndërprerje e anëtarësimit. Shumat e kontributeve vullnetare përcaktohen nga siguruesi, për të gjithë pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale, të cilën ai e organizon dhe e financon dhe i përcakton si përqindje të rrogës së anëtarit, i cili përfshihet në skemën pensionale profesionale.

Gjatë vitit 2024 në fondet vullnetare pensionale janë paguar gjithsej rreth 533,92 milionë denarë, që është rreth 0,06% e PBVsë së RMV-së. Kontributet e paguara detajisht sipas muajve (në milionë denarë) janë paraqitur në Tabelën 6.2.


Tabela 6.2. Kontributet në shtyllën e tretë sipas muajve dhe fondeve

(në milionë denarë)

	Totali 2023	Jan.	Shkurt.	Mars.	Prill.	Maj	Qer.	Korr.	Gusht.	Shtat.	Tet.	Nen.	Dhjet.	Gjithsej 2023
SAVAv	219,77	16,20	14,05	21,65	19,66	19,07	14,65	22,42	14,89	14,95	19,33	20,71	41,98	239,55
KBPv	196,20	10,50	15,03	13,49	16,38	17,15	24,05	11,52	16,83	14,00	16,93	40,65	65,47	262,01
TRIGLAVv	3,37	0,16	0,16	0,17	0,31	0,18	0,34	0,25	0,23	0,46	0,33	0,81	0,55	3,94
VFP	12,61	0,34	0,89	0,80	1,57	1,55	7,43	2,81	0,73	1,33	1,98	1,76	7,23	28,43
Gjithsej	431,95	27,20	30,13	36,10	37,92	37,96	46,46	37,00	32,68	30,74	38,57	63,92	115,23	533,92

Në vitin 2024, kontributet e përgjithshme vullnetare të paguara në shtyllën e tretë shënuan rritje prej 23,61% krahasuar me vitin 2023. Krahasuar me vitin paraprak, shuma e kontributeve të përgjithshme vullnetare të paguara u rrit në të gjitha fondet e pensione vullnetare, kështu që në SAVAv u rrit me 9,00%, në KBPv me 33,54%, në TRIGLAVv me 33,54% dhe në VFP me 125,48%. Për sa i përket fondeve, në vitin 2024, SAVAv dhe KBPv kanë një shpërndarje pothuajse identike të kontributeve, ku shumica e kontributeve vullnetare janë paguar në llogaritë vullnetare individuale (52,77% në SAVAv dhe 52,43% në KBPv). Në TRIGLAVv, më shumë se dy të tretat e kontributeve janë paguar në llogari individuale vullnetare (68,29%), ndërsa në VFPv, shumica e kontributeve vullnetare janë paguar në llogaritë profesionale (53,74%). Shpërndarja e pagesave sipas llojit të llogarisë në të cilën janë paguar dhe sipas fondeve, në baza mujore, jepet në Grafikon 6.6.

Grafiku 6.6. Shpërndarja e pagesave në shtyllën e tretë sipas llojit të llogarisë dhe sipas fondit



6.5 Investimi dhe struktura e portfolit të fondeve pensionale vullnetare

Edhe në sigurimin vullnetar pensional me financim kapital, si në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, në fazën fillestare përdoret kontrollimi proaktiv dhe kufizimet sasiore dhe cilësore të investimeve. Megjithatë, në dallim nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital, në sigurimin vullnetar pensional me financim kapital ka kushte më liberale lidhur me investimin.


Përveç instrumenteve të lejuara në fondet e detyrueshme pensionale, në fondet pensionale vullnetare, për investimet jashtë vendit, lejohet edhe investimi në letrat debitoare me vlerë, të emetuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore, si dhe nga letrat debitoare me vlerë, të emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale. Meqë është e domosdoshme të arrihet diversifikimi adekuat midis llojeve të ndryshme të investimeve dhe fondeve vullnetare pensionale, parashihen kufizimet maksimale për investimin në kompani të caktuar dhe në grup ekonomik të caktuar dhe kufizime maksimale në shumat që mund të investohen në lloje të caktuara instrumentesh. Për t'i parandaluar investimet në instrumentet që nuk janë të përshtatshme për të investuar në fondet vullnetare pensionale, janë të ndaluara me ligj investimet në aksionet, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë, të cilat nuk kuotojnë në tregun zyrtar ose që nuk tregtohen publikisht, instrumentet me të cilat nuk mund juridikisht të disponohen, instrumentet që nuk mund të vlerësohen menjëherë, më shumë forma të pronës që nuk mund të vlerësohen menjëherë dhe zërat me vlerë të pasigurt. Kufizimet maksimale të investimeve janë paraqitur në Tabelën 6.3.

Tabela 6.3. Kufizimet maksimale të investimit


Lloji i instrumentit	Limiti maksimal
Investimet jashtë vendit (BE, OECD)	50%
obligacione dhe letra të tjera me vlerë të emetuara nga qeveritë e huaja dhe bankat qendrore të vendeve të huaja dhe letrat debitoare me vlerë të emetuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore	50%
letra debitoare me vlerë të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, kompanive të huaja joqeveritare ose bankave dhe dokumentet për kuota dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga fondet e investimeve	30%
Letra me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga tregu vendas i RMV ose BPRMV	80%
Depozita bankare, certifikata depozitash, akte komerciale, obligacione dhe letra të tjerame vlerë, mbi bazën e hipotekave të lëshuara nga bankat vendase.	60%
Obligacione të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe shoqëritë aksionare vendase që nuk janë banka dhe akte komerciale nga shoqëritë aksionare vendase që nuk janë banka	40%
obligacione të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale	10%
Aksione të lëshuara nga shoqëritë aksionare vendase	30%
Dokumente për pjesëmarrje dhe aksione të fondeve maqedonase të investimit	5%

Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve vullnetare SAVAv dhe KBPv, që nga fillimi i funksionimit të fondeve të pensioneve vullnetare (për periudhën 2009 - 2023, në baza vjetore dhe për vitin 2024, në baza tremujore), është pasqyruar në Grafikon 6.7. dhe Grafikon 6.8. Struktura e investimeve të fondit të pensioneve vullnetare TRIGLAVv që nga fillimi i funksionimit të fondit (1.3.2021) dhe në baza tremujore për vitin 2024 është paraqitur në Grafikon 6.9. Struktura e investimeve të fondit të pensioneve vullnetare VFPv (për periudhën nga fillimi i funksionimit të fondit 18.10.2022 - 2023) në baza tremujore për vitin 2024 është pasqyruar në Grafikon 6.10.


Grafiku 6.7. Struktura e investimeve në SAVAv




Grafiku 6.8. Struktura e investimeve nëKBPV



Grafiku 6.9. Struktura e investimeve në TRIGLAVv




Grafiku 6.10. Struktura e investimeve nëVFPv




Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensinale, me bilancin e datës 31.12.2024, nuk dallon shumë në krahasim me strukturën e investimeve të fondeve vullnetare pensionale me bilancin e datës 31.12.2023 dhe është paraqitur në grafikun 6.11. Pjesëmarrja e obligacioneve të brendshme, të cilat përfshijnë vetëm obligacionet e qeverisë, është 55.76%, që është pak më e ulët se shifra e bilancit të 31.12.2023 (56,06%). Pjesëmarrja e depozitave në bankat vendase gjithashtu ka rënë dhe është 4.90%. Pjesëmarrja e aksioneve të emetuesve vendas është në rënie krahasuar me një vit më parë dhe është 5.96%. Një pjesë shumë e vogël

e investimeve të fondeve pensionale vullnetare i takon investimeve në aksione të fondeve të investimeve vendase (1.25%). Në vitin 2024, pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit është rritur, krahasuar me një vit më parë, dhe është 31.37%. Në vitin 2024, tre fonde pensionesh kanë investuar edhe në obligacione qeveritare të huaja, dhe një fond pensioni ka investuar gjithashtu në obligacione të korporatave të huaja, kështu që investimet në letrat me vlerë të huaja përfshijnë investime në obligacione të huaja qeveritare (2.65%), obligacione të korporatave të huaja (0.16%), aksione të fondeve të investimeve (24.12%) dhe investime në aksione (4.4%). Asetet e mbetura janë para të gatshme 0.55% dhe të arkëtueshme 0.20%.

Grafiku 6.11. Struktura e investimeve në shtyllën e tretë, bilanci i 31.12.2024



Grafiku 6.12. Klasat e fondeve në portofolin FVP krahasuar me kufizimet ligjore




Gjatë vitit 2024, katër fondet e pensione vullnetare kanë investuar brenda kufijve maksimalë të investimeve. Grafiku 6.12 tregon përqindjen e pjesëmarrjes në portofol sipas kategorive të aktiveve në SAVAv, KBPv, TRIGLAVv dhe VFPv dhe kufizimet ligjore me bilancin e datës 31.12.2024.

Fondet vullnetare të pensioneve kanë një ekspozim më të lartë të aktiveve ndaj aksioneve të emetuesve vendas (5.96%) krahasuar me fondet e pensioneve të detyrueshme, megjithëse ekspozimi ndaj aksioneve të emetuesve vendas është i ndryshëm për të gjitha fondet e pensione. Për më tepër, ekspozimi ndaj aksioneve të emetuesve vendas është dukshëm më i lartë për SAVAd (8.39%) dhe VFPd (9.22%) krahasuar me KBPd (3.26%). TRIGLAVd më 31.12.2024 nuk ka investime në aksione të emetuesve vendas.

Krahasimisht, lëvizjet e vlerës së Indeksit të Bursës së Maqedonisë (MBI10), Indeksi i Bonove të Bursës së Maqedonisë (OMB) dhe vlerat e njësive kontabël të fondeve vullnetare pensionale gjatë vitit 2024 janë të evidentuara në Grafikon 6.13. Vlera e njësive kontabël të SAVAv shënoi një rritje prej 10.45%, vlera e njësive kontabël të KBPv u rrit me 9.47%, vlera e njësive kontabël të TRIGLAV u rrit me 9.43% dhe vlera e njësive kontabël të VFPv shënoi një rritje prej 14.55%. MBI10, gjatë vitit 2024, ka shënuar një rritje me rreth 66,78% .. OMB, gjatë vitit 2023, ka shënuar një rritje prej rreth 0,76%.

Grafiku 6.13. Lëvizja krahasuese e vlerës së MBI10, OMB dhe vlerës së njësive kontabël të FVP, viti 2024




²⁴ Lëvizjet tregohen nëpërmjet ndryshimit të indekseve/njësive në raport me një indeks fillestar të barabartë me 100, më 31.12.2023


²⁵ Burimi: Bursa e Maqedonisë SHA Shkup - Buletini vjetor statistikor 2024.

Edhe në fondet vullnetare pensionale, pjesa më e madhe e mjeteve në vitin 2024 ishin investuar në letra shtetërore me vlerë, përkatësisht letra shtetërore vendase me vlerë (54,78% në SAVAv, 57,64% në KBPv, 59,69% në TRIGLAVv dhe 44,39% në VFPv) dhe në letra të huaja shtetërore me vlerë (1,58% në SAVAv, 3,66% në KBPv dhe 4,13% në VFPv). Menjëherë pasojnë investimet në instrumente nga emetuesit / shoqëritë aksionare nga sektori financiar (29,04% në SAVAv, 36,59% në KBPv, 37,30% në TRIGLAVv dhe 42,87% në VFPv). Në kuadër të këtij sektori, në SAVAv më e madhe është pjesëmarrja e aksioneve në fondet e huaja dhe vendase të investimeve (73,95%) dhe depozitat bankare vendase (12,02%), aksionet në bankat vendase (8,55%), shërbimet financiare (4,36%) dhe obligacionet e emetuara nga bankat vendase dhe të huaja (1, 13%). Në KBPv brenda sektorit financiar, mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja (79,43%), pjesa tjetër i përket depozitave bankare vendase (15,74%). Edhe në TRIGLAVv, tek pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja dhe vendase mbizotëron sektori financiar (87,91%), ku pjesa tjetër është në depozitat bankare vendase (12,09%). Tek VFPv, brenda sektorit financiar, mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja dhe vendase (65,59%) me pjesën tjetër që i përket depozitave bankare vendase (28,59%) dhe aksioneve bankare vendase (5,82%). Përveç sektorëve të mësipërm, fondet vullnetare pensionale investojnë në sektorë të tjerë: mallrat bazë, mallrat farmaceutike, mallrat e konsumit, industrinë, teknologjinë e informacionit dhe shërbimet e komunikimit, por me një pjesëmarrje shumë më të vogël (nga 0.50% në 4.87%). Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale, sipas sektorëve, është pasqyruar në Grafikon 6.14.

Grafiku 6.14. Struktura e Investimeve të FVP sipas sektorëve



Grafiku 6.15. Struktura valutore e fondeve të FVP, 2023-2024




Lidhur me strukturën valutore të mjeteve të fondeve të pensioneve vullnetare, të paraqitur në grafikun 6.15, vihet re se SAVAv dhe KBPv kanë një strukturë të ngjashme valutore. Gjegjësisht, në vitin 2024, pjesa më e madhe e aseteve të SAVAv janë investuar në instrumente në valutën vendase (51.63%), ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro është 24.74%. Në SAVAv, pjesëmarrja në instrumente në denarë mbetet në rritje krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro është në rënie. Në KBPv pjesa më e madhe e aktiveve është investuar në instrumente në valutën vendase (44.88%), ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro është 27.79%. Në vitin 2024, krahasuar me vitin e kaluar, në KBPv, pjesëmarrja në instrumente në denarë rritet, ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro zvogëlohet. Pjesëmarrja e investimeve në dollarë amerikanë si në SAVAv (23.17%) edhe në KBPv (27.34%) është ulur krahasuar me një vit më parë. Struktura valutore e SAVAv përfshin gjithashtu një pjesë të vogël të instrumenteve në franga zvicerane 0.45%. Struktura e monedhës së TRIGLAVv ndryshon nga struktura e monedhës së SAVAv dhe KBPv. Pjesëmarrja e aseteve të TRIGLAVv vazhdon të jetë në anën e mjeteve të investuara në instrumente në denarë (64,75%). Në vitin 2024 vërehet rritje e pjesëmarrjes së instrumenteve në valutë, pra 7.23% e aktiveve të TRIGLAVv janë investuar në instrumente në euro dhe 28.02% e mjeteve janë investuar në instrumente në dollarë amerikanë. Struktura e monedhës së VFPv gjithashtu ndryshon nga strukturat valutore të SAVAv, KBPv dhe TRIGLAVv. Në VFPv, pjesëmarrje më e madhe e aktiveve është investuar në instrumente në monedhë vendase (61.47%), e ndjekur nga pjesëmarrja në instrumente në euro (33.47%) dhe pjesa më e vogël është në instrumente në dollarë amerikanë (5.06%).

Nëse bëhet krahasimi me vendet që kanë sisteme të ngjashme pensionale me atë maqedonase, mund të vërehen ngjashmëri, por edhe dallime në portfolet e investimeve të fondeve vullnetare pensionale. Në Grafikun 6.16. është dhënë krahasimi i investimeve, më 31.12.2024, të fondeve vullnetare pensionale në RMV, me investimet e fondeve vullnetare pensionale në disa nga vendet e rajonit që kanë zbatuar sigurimin vullnetar pensional me financim kapital²⁶

Nëse portfolet e fondeve vullnetare pensionale shqyrtohen sipas instrumenteve, mund të vërehet se fondet e pensioneve në pothuajse të gjitha vendet kanë ekspozimin më të lartë ndaj obligacioneve dhe letrave të tjera me vlerë të garantuara nga shteti ose qeveria lokale (në Rumani 68%, në Maqedoninë e Veriut 58%, në Kroaci 53%, dhe me përqindjen më të ulët në Bullgari 51%). Ekspozimi ndaj depozitave bankare është më i larti në Maqedoninë e Veriut dhe në Kroaci dhe arrin në 5%. Në Rumani dhe Bullgari, ekspozimi ndaj depozitave është dukshëm më i ulët (rreth 2% në Rumani dhe më pak se 1% në Bullgari). Për sa i përket investimeve në aksione dhe kuota (pjesëmarrje), përqindja më e lartë e aseteve në aksione dhe kuota investohet nga fondet pensionale në Bullgari (43%), Maqedonia e Veriut (36%), Kroacia (34%) dhe Rumania (27%). Fondet e pensioneve investuan gjithashtu në obligacione të korporatave, përkatësisht 5% nga fondet e pensioneve në Bullgari, 4% në Rumani dhe 3% në Kroaci. Krahasuar me fondet pensionale në vendet e tjera, përqindja e investimeve në bono të korporatave në mesin e fondit pensional në Maqedoninë e Veriut është më e ulët, 0,16%. Vetëm në Bullgari fondet e pensioneve kanë investuar në pasuri të paluajtshme (1%), ndërsa në vendet e tjera ky instrument zakonisht nuk lejohet. Për sa i përket investimit jashtë vendit²⁷, fondet pensionale në Kroaci kanë ekspozimin më të lartë ndaj investimeve të huaja me 33%, të ndjekura nga fondet pensionale në Maqedoninë e Veriut me 31%..

Grafiku 6.16. Portfolet e fondeve vullnetare pensionale në disa vende dhe në RMV



²⁴ Burime: www.hanfa.hr; www.fsc.bg; www.asfromania.ro dhe llogaritjet personale

²⁵ Të dhënat e investimeve të huaja për Bullgarinë që nga data 31.12.2023 nuk janë të disponueshme në të dhënat e shkarkuara

²⁶ Burime: www.hanfa.hr; www.fsc.bg; www.asfromania.ro dhe llogaritjet personale.

²⁷ Burimi për PBV: Enti Shtetëror i Statistikave - Njoftim - Prodhimi Bruto Vendor, për vitin 2024.

6.6 Mjetet neto, njësia kontabël dhe norma e rendimentit të fondeve pensionale vullnetare

Mënyra e llogaritjes së neto-mjeteve, njësisë së kontabilitetit dhe rendimentit të fondeve vullnetare pensionale është e njëjtë si edhe për fondet e detyrueshme pensionale.

Ndryshimet në mjetet e fondeve vullnetare pensionale nga fillimi deri në fund të vitit ndodhin për shkak të:

- të hyrave të kontributeve,
- të dalave për shkak të kompensimeve dhe provizioneve të transaksionit,
- të hyrave për shkak të kthimit të tatimit personal,
- të dalave për shkak të pagesës së gabuar të kontributit të konvertuar,
- të hyrave për shkak të transferimit nga fondi tjetër vullnetar pensional (për personat që kanë qenë anëtarë të fondit tjetër, dhe më pas janë transferuar në fondin aktual),
- të dalave për shkak të transferimit nga fondi tjetër vullnetar pensional (personat që kanë qenë në fondin përkatës, dhe më pas janë transferuar në fondin tjetër),
- të dalave për shkak të pagesës së trashëgimisë,
- të dalave për shkak të pagesës së kompensimeve pensionale (pagesat e njehershme dhe të shumëhershme),
- fitimeve / humbjeve të (pa)realizuara nga investimet.

Duke u nisur nga vlera e mjeteve neto, në fund të vitit paraprak, dhe duke i marrë parasysh të gjitha ndryshimet e mësipërme, vijmë te vlera e mjeteve neto në fund të vitit, (që është paraqitur në Tabelën 6.4.).

Tabela 6.4. Ndryshimet në mjetet e fondeve vullnetare pensionale

(në milione denare)

	SAVAv	KBPv	TRIGLAVv	VFPv	Gjithsej
Mjetet neto më 31.12.2023	1.763,84	1.738,27	10,65	72,30	3.052,19
Kontributet	239,55	262,01	3,94	28,43	431,95
Kompensimet e kontributeve	5,45	6,36	0,11	0,73	10,23
Kontributet e zvogëluara për kompensimet e kontributeve	234,10	255,65	3,83	27,70	421,71
Pagesa e llogarisë individuale nga kthimi i tatimit personal	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Të dalat për pagesën e gabuar të kontributit të konvertuar	0,14	0,82	0,50	0,30	0,37
Kompensimet e mjeteve	17,36	16,78	0,13	1,06	29,41
Shpenzimet për provizionet ndërmjetësuese	0,31	0,16	0,00	0,06	0,22
Transferimi nga fondi tjetër	14,41	9,15	4,30	52,76	55,87
Transferimi në fondin tjetër	31,28	48,20	0,22	0,66	55,87
Pagesa e trashëgimisë	2,44	1,60	0,00	0,00	13,43
Pagesa e kompensimit pensional - pagesa e njehershme / pagesa e shumëhershme	49,04	61,32	0,00	1,55	109,12
Fitimi bruto nga investimet	207,58	185,58	1,41	17,03	202,69
Fitimi neto nga investimet	189,91	168,65	1,29	15,90	173,06
Neto mjetet më 31.12.2024.	2.119,35	2.059,77	19,35	166,14	3.585,06


Mjetet e përgjithshme neto në fondet vullnetare pensionale, me 31.12.2024, arritën në rreth 4,36 miliardë denarë ose rreth 70, 97 milionë euro, që paraqet rreth 0,46% të PBV-së²⁸.

Në Grafikun 6.17. tregohen vlerat e mjeteve neto në fund të të gjitha viteve dhe rritja e tyre në përqindje krahasuar me mjetet neto të një viti më parë. Në të njëjtën kohë, mund të vërehet se mjetet neto të SAVAv dhe KBPv rriten me një trend të ngjashëm. Rritja më e lartë është vërejtur në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, ndërsa rritja më e ulët është vërejtur në vitin 2022 krahasuar me 2021. Rritja e mjeteve të SAVAv dhe KBPv në vitin 2023 dhe 2024 krahasuar me vitin paraprak tashmë po ndjek trendin e pritur. Në TRIGLAVv dhe VFPv, një rritje e madhe e mjeteve neto mund të vërehet në vitin e dytë të funksionimit të fondeve në krahasim me vitin e parë.


Lëvizja e vlerës së neto-mjeteve dhe kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e neto-mjeteve në SAVAv dhe KBPv, janë paraqitur në Grafikun 6.18. dhe në Grafikun 6.19. Rritja e neto-mjeteve të fondeve vullnetare pensionale është implikuar nga rritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet e investimeve. Pas rënies të rritjes në vitin 2022, për vitin 2023 shënohet sërish rritje e neto mjeteve. Pjesëmarrja e kontributeve kumulative në neto-mjetet e përgjithshme gjatë viteve të para është dukshëm më e lartë dhe më pas shënoi rënie me përjashtim të vitit 2022.

²⁸ Burimi për PBV: Enti Shtetëror i Statistikave - Njoftim - Prodhimi Bruto Vendor, për vitin 2024


Grafiku 6.17. Rritja e mjeteve neto të SAVAv, KBPv, TRIGLAVv dhe FVPv në përqindje krahasuar me një vit më parë




Grafiku 6.18. Rritja e mjeteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në SAVAv




Grafiku 6.19. Rritja e mjeteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në KBPv



Grafiku 6.20. Rritja e mjeteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në TRIGLAVv



Grafiku 6.21. Rritja e mjeteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në TRIGLAVv




Në SAVAv, pas rritjes së reduktuar të mjeteve neto të SAVAv në vitin 2022 (5%), në vitin 2023 vërehet sërish një ngritje e rritjes së mjeteve neto dhe në vitin 2024 ka një rritje prej (20%). Ndërsa, pas uljes me 1% të kontributeve të paguara në vitin 2022, në vitin 2023 vërehet rritje e kontributeve të paguara, ndërsa në vitin 2024 edhe pse ka ulje sërish vërehet një rritje në krahasim me vitin e kaluar prej 9%. Gjithashtu, në vitin 2023 e dhe tek KBPv, pas rritjes së reduktuar në vitin 2022, ka një ngritje të rritjes së mjeteve neto në vitin 2024 prej (18%). Sa i përket kontributeve të paguara në vitin 2022 dhe 2023, vërehet një rritje prej 34%. Lëvizja e vlerës së mjeteve neto dhe kontributeve kumulative si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e mjeteve neto të TRIGLAVv, për periudhën 2021 - 2024, dhe e VFPv për tre vitet e funksionimit, 2022 dhe 2024 janë paraqitur në Grafikon 6.20. dhe Grafiku 6.21., në mënyrë adekuate. Në TRIGLAVv vërehet një rritje e rritjes së mjeteve neto (82%) dhe rritje të kontributeve të paguara në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 me 17%. Rritja e aseteve neto të TRIGLAVv është për shkak të pothuajse në mënyrë të barabartë të kontributeve të paguara dhe të aseteve të transferuara nga fondet e tjera të pensioneve në TRIGLAVv bazuar në marrëveshjet e lidhura për transferimin në TRIGLAVv. Në VFPB, vërehet një rritje e aseteve neto dhe kontributeve të paguara në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023. Rritja e aseteve neto të VFPv, përveç se nënkuptohet nga rritja e kontributeve të paguara, është edhe për shkak të aseteve të transferuara nga fondet e tjera të pensioneve në VFPv bazuar në marrëveshjet e lidhura për transfer në VFPv.

Tabela 6.6 Vlera e njësive të kontabilitetit që nga fillimi i ekzistencës së FVP-së


Data	Vlera e njësive llogariatë			
	SAVAv	KBPv	TRIGLAVv	VFP
15.09.2009	100,000000			
21.12.2009	102,815757	100,000000		
31.12.2009	103,061825	100,204385		
31.12.2010	107,592926	106,891617		
31.12.2011	111,854726	112,639593		
31.12.2012	118,742851	119,129537		
31.12.2013	130,511147	129,015451		
31.12.2014	140,946772	139,908803		
31.12.2015	147,535595	146,709341		
31.12.2016	154,578083	154,465341		
31.12.2017	164,155073	162,989756		
31.12.2018	169,649887	163,696595		
31.12.2019	188,197689	181,404697		
31.12.2020	191,209810	188,085163		
31.12.2021	210,750156	207,793725	103,476074	
31.12.2022	204,936103	201,600542	101,945390	98,791716
31.12.2023	222,263888	214,618876	108,442676	118,645563
31.03.2024	231,504947	222,452526	112,041644	112,144969
30.06.2024	235,176217	225,480042	113,844699	114,716620
30.09.2024	240,202610	228,820487	115,527613	117,712019
31.12.2024	245,411182	232,918767	117,672165	121,015331

Lëvizja e vlerës së njësive kontabël të fondeve vullnetare pensionale, nga fillimi i funksionimit të fondeve vullnetare pensionale, deri më 31.12.2024, jepet në tabelën 6.5., në grafikon 6.21. dhe në grafikon 6.22. Për më tepër, që nga fillimi i funksionimit të SAVAv dhe KBPv, vërehet një trend në rritje i njësive të kontabilitetit. Më 1.03.2021 filloi të funksionojë fondi i tretë i pensioneve vullnetare, TRIGLAVv. Më 18.10.2022 filloi të funksionojë fondi i katërt i pensioneve vullnetare, VFPv. Në vitin 2024, vlerat e njësive kontabël të katër fondeve vullnetare pensionale shënuan sërish rritje pas devijimit nga trendi i rritjes në vitin 2022 (10.45% e SAVAv, 9.47% e KBPv, 9.43% e TRIGLAVv dhe 14.55% e VFPv). Megjithatë, fondet pensionale, nga vetë natyra e tyre, punojnë për një afat të gjatë, kështu që performanca e tyre duhet të vlerësohet në afat të gjatë.

Grafiku 6.21. Vlera e njësive të kontabilitetit që nga fillimi i ekzistencës së FVP-së



Grafiku 6.22. Vlera e njësive të kontabilitetit të FVP-së në vitin 2024



Rendimenti i fondeve të pensioneve vullnetare sipas periudhave, i reduktuar në nivel vjetor, tregohet në tabelën 6.6 ²⁹

Tabela 6.6 Rendimenti i FVP

Periudha ³⁰	SAVAv		KBPv		TRIGLAVv		Në shumë nominale	Në shumë reale
	Në shumë nominale	Në shumë reale	Në shumë nominale	Në shumë reale	Në shumë nominale	Në shumë reale		
31.12.2009-31.12.2010	4,40%		6,67%					
31.12.2009-31.12.2011	4,18%		6,02%					
31.12.2009-31.12.2012	4,83%		5,93%					
31.12.2009-31.12.2013	6,08%	3,00%	6,52%	3,42%				
31.12.2009-31.12.2014	6,46%	4,09%	6,90%	4,52%				
31.12.2009-31.12.2015	6,16%	4,25%	6,56%	4,64%				
31.12.2009-31.12.2016	5,96%	4,36%	6,37%	4,77%				
31.12.2010-31.12.2017	6,22%	4,72%	6,21%	4,71%				
31.12.2011-31.12.2018	6,13%	4,91%	5,48%	4,27%				
31.12.2012-31.12.2019	6,80%	6,22%	6,19%	5,62%				
31.12.2013-31.12.2020	5,60%	4,90%	5,53%	4,82%				
31.12.2014-31.12.2021	5,91%	4,41%	5,81%	4,31%				
31.12.2015-31.12.2022	4,80%	0,77%	4,64%	0,61%	-	-		
30.06.2021-31.12.2022	-	-	-	-	0,84%	-11,60%		
31.12.2016-31.12.2023	5,32%	0,71%	4,81%	0,22%	-	-	-	-
30.06.2021-31.12.2023	-	-	-	-	3,01%	-6,16%	-	-
31.12.2022-31.12.2023	-	-	-	-	-	-	8,20%	4,42%
31.03.2017-31.03.2024	5,51%	0,84%	5,00%	0,35%	-	-	-	-
30.06.2021-31.03.2024	-	-	-	-	3,96%	-4,81%	-	-


²⁹ TRIGLAVv dhe VFPv përfshihen në analizat krahasuese të kontributit me kontributin e llogaritur për periudhat përkatëse, në përputhje me rregullativën, sepse ekzistojnë më gjatë se 12 muaj, por më shkurt se 84 muaj.

³⁰ Deri në miratimin e ndryshimeve në Ligjin për Sigurimin Pensional Vullnetar me Financim Kapital, nga janari 2013, rendimenti i fonditvullnetar pensional llogaritej për një periudhë 3-vjeçare, vetëm në shumën nominale.


Periudha ³⁰	SAVAv		KBPv		TRIGLAVv			
31.12.2022-31.03.2024	-	-	-	-	-	-	10,68%	6,77%
30.06.2017-30.06.2024	5,65%	1,01%	5,16%	0,54%	-	-	-	-
30.06.2021-30.06.2024	-	-	-	-	4,18%	-4,32%	-	-
12.31.2022-30.06.2024	-	-	-	-	-	-	10,49%	6,31%
30.09.2017-30.09.2024	5,52%	0,62%	5,11%	0,23%	-	-	-	-
30.06.2021-30.09.2024	-	-	-	-	4,31%	-4,02%	-	-
31.12.2022-30.09.2024	-	-	-	-	-	-	10,23%	5,74%
31.12.2017-31.12.2024	5,91%	1,00%	5,36%	0,47%	-	-	-	-
30.06.2021-31.12.2024	-	-	-	-	4,80%	-3,14%	-	-
31.12.2022-31.12.2024	-	-	-	-	-	-	11,31%	7,03%
Fillimi* - 31.12.2024	5,98%	2,83%	5,84%	2,63%	4,56%	-3,28%	9,78%	5,74%

* Fillimi i SAVAv është më 15.7.2009, për KBPv më 21.12.2009, për TRIGLAVv më 1.3.2021. dhe për VFPv më 18.10.2022

Grafiku 6.23 Rendimenti i FVP (në vlerë nominale)



Grafiku 6.24. Rendimenti në vlerë nominale dhe reale të FVP, 2013 – 2024



Rendimenti i llogarisë vullnetare individuale dhe/ose profesionale është i ndryshueshëm dhe varet nga rendimenti fondit vullnetar pensional dhe tarifat e arkëtuara nga kompania. Rendimenti, pra fitimi, është një parametër që realisht nuk mund të parashikohet, sepse varet nga kushtet e tregut të kapitalit dhe në ekonominë e përgjithshme.

Rendimenti i fondeve vullnetare pensionale llogaritet në të njëjtën mënyrë dhe sipas të njëjtës formulë si rendimenti i fondeve të detyrueshme pensionale

Duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të sigurimit të pensioneve, është mirë të llogaritet rendimenti i fondeve të pensioneve vullnetare që nga fillimi i ekzistencës së tyre, i reduktuar në një nivel vjetor, i cili për SAVAv është 5.981% në vlerën nominale, ose 2.83% në vlerën reale, për KBPv 5.84% në vlerën nominale, ose 2.63% në vlerën reale, për TRIGLAVd 4.56% në vlerën nominale, ose -3.28% në vlerë reale, dhe për VFPv rendimenti është 9.78% në vlerë nominale, ose 5.74% në vlerë reale.

Lëvizja e rendimentit në vlerë nominale, sipas periudhave, mund të shihet në Grafikon 6.24., i cili tregon rendimentet sipas periudhave, nga 31.12.2009 deri më 31.12.2024, sipas fondeve. Në fillim, vërehet një rritje e rendimentit, kështu që, në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, vërehen rendimente të larta në të dy fondet e pensioneve vullnetare, ndërsa në fund të vitit 2011, pati një rënie të rendimenteve. Më pas, në vitet në vijim, vërehet një rritje graduale e rendimentit deri në mesin e vitit 2015, pas së cilës vërehet një rënie e rendimentit, deri në mesin e vitit 2016, dhe më pas vërehet përsëri një rritje e rendimentit, përfshirë fundin e vitit 2016. Në vitin 2019, vërehet një rritje e rendimentit krahasuar me rendimentin në fund të vitit 2018. Në vitin 2020, u regjistruan rendimente më të ulëta krahasuar me vitin 2019 për SAVAv dhe KBPv, kryesisht për shkak të kushteve të pafavorshme në tregjet financiare në kontekstin e pandemisë së koronavirusit. Pas rënies së rendimenteve në vitin 2022 për shkak të krizës globale të shkaktuar nga konflikti ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë, në vitin 2023, u regjistrua një rritje e lehtë e rendimenteve për SAVAv dhe KBPv. TRIGLAVv në vitet e para të funksionimit të saj dhe në rrethana të jashtëzakonshme për shkak të kushteve të pafavorshme në tregjet financiare regjistroi një kthim në një shumë nominale më të vogël se zero, i cili u kompensua tashmë në periudhën pasuese dhe në vitin 2023 u regjistrua një rritje e rendimentit krahasuar me vitin 2022. VFPv

regjistroi një rendiment të lartë në vitin e parë të funksionimit të saj. Në vitin 2024, u regjistrua një rritje e rendimentit për të gjitha fondet e pensione.

Rendimenti shtatëvjeçar në nivelin e sigurimit vullnetar pensional të financuar me kapital për periudhën 31.12.2016 – 31.12.2024, i llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar³¹ të njësive kontabël të fondeve vullnetare pensionale, reduktuar në nivel vjetor është 5,33% në vlerë nominale, pra 0,44% në vlerë reale.

6.7 6.7. Kompensimet në fondet vullnetare pensionale

Për ushtrimin e funksioneve të tij të menaxhimit të mjeteve të fondit vullnetar pensional, vlerësimit të mjeteve, anëtarësimit, mbajtjes së llogarive vullnetare individuale dhe profesionale të anëtarëve dhe për njoftimin e anëtarëve, si dhe për pagesën e kompensimeve për MAPAS-in dhe për kujdestarin e pronës, shoqëritë, në përputhje me Ligjin për Sigurim Vullnetar Pensional me Financim Kapital arkëtojnë kompensim për kontributet, kompensim për mjetet/fondet dhe kompensim për transferimin.

Kompensimi i kontributeve arkëtohet si përqindje e çdo kontributi të paguar në fondin vullnetar pensional, përpara shndërrimit të tij në njësitë e kontabilitetit. Ky kompensim arkëtohet nga shoqëria në të njëjtën përqindje, nga të gjithë anëtarët e fondit vullnetar pensional, përveç në rastin e anëtarëve që janë pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale ose në rastin e anëtarësimit shumëvjeçar. Kompensimi mujor i mjeteve është përqindja e vlerës së mjeteve neto të fondit vullnetar pensional, e cila llogaritet në çdo datë të vlerësimit të mjeteve të fondit vullnetar pensional (në përputhje me rregullativën nënligjore në fuqi, data e vlerësimit është çdo ditë) dhe arkëtohet një herë në muaj. Kompensimi i transferimit arkëtohet në rast të transferimit të anëtarit nga njëri fond vullnetar pensional në fondin tjetër vullnetar pensional, me kusht që anëtari që transferohet të ketë qenë anëtar i fondit ekzistues vullnetar pensional më pak se një vit.

Ligji i përcakton shumat maksimale, ndërsa shoqëritë janë të lira t'i përcaktojnë shumat e llojeve të veçanta të kompensimeve në kuadër të maksimumit ligjor.

Kompensimet e arkëtuara nga shoqëritë që menaxhojnë fondet vullnetare pensionale në RMV, për vitin 2024, janë pasqyruar në Tabelën 6.7.

Tabela 6.7 Kompensimet e arkëtuara nga shoqëritë që i menaxhojnë fondet vullnetare pensionale në vitin 2024

Lloji kompensimit	SAVA	KB e Para	TRIGLAV	VFP
Kompensim nga kontributet*	2,50% ³²	2,50% ³³	2,90%	2,90%
Kompensim mujor nga vlera e neto mjeteve në fondin pensional vullnetar	0,100% ³⁴	0,075% ³⁵	0,075%	0,075%
Kompensim per kalim				
Numri i diteve**	Shuma e kompensimit të transferimit	Shuma e kompensimit të transferimit	Shuma e kompensimit të transferimit	Shuma e kompensimit të transferimit
numri i ditëve ≤ 360	10 euro	10 euro	10 euro	10 euro
numri i ditëve > 360	Nuk paguhet kompensimi i transferimit	Nuk arkëtohet kompensimi i transferimit	Nuk arkëtohet kompensimi i transferimit	Nuk arkëtohet kompensimi i transferimit

*Per anetaret qe jane pjesemarres ne skemen pensionale profesionale,shoqeria pensionale mund te percaktoje vlere te vogel te kompensimit.

**Numri i diteve percaktohet ne baze te numrit te diteve kur anetari ka fituar statusin e anetarit ne fondin pensionalvullnetar ekzistues deri ne daten e nenshkrimit te kontrates me fondin pensional vullnetar te ardhshem.

Vlera e kompensimeve të kontributeve, të cilat janë arkëtuar nga fillimi i punës së shtyllës së tretë, përfshirë edhe vitin 2024, është pasqyruar në Tabelën 6.8.

³¹ Vlera mesatare llogaritet si mesatare e ponderuar e njësive kontabël të fondeve vullnetare pensionale në raport me mjetet neto të fondeve vullnetare pensionale

³² Nga 1 maji 2021 (paraprakisht ishte 2,90%).

³³ Nga 1 qershori 2023 (paraprakisht ishte 2,90%). %).

³⁴ Nga 1 maji 2021 (paraprakisht ishte 0,100%).

³⁵ Nga 1 janari 2011 (paraprakisht ishte 0,15%).

Tabela 6.8. Vlera e kompensimeve nga kontributet e arkëtuara nga shoqëritë pensionale në shtyllën e tretë

Shoqeria pensionale	Vlera	Data e zbatimit
SAVA	5,25%	Nga fillimi i punës së fondit (15 korriku, 2009)
	3,80%	Nga 1 marsi 2011
	2,90%	Nga 1 janari 2017
	2,50%	Nga 1 maji i 2021
KB e Para	5,50%	Nga fillimi i punës së fondit (21 dhjetor 2009)
	4,00%	Nga 24 prilli i 2010
	2,90%	Nga 1 qershori i 2013
	2,50%	Nga 1 janari, 2023
TRIGLAV	2,90%	Nga 1 marsi 2021.
VFP	2,90%	Nga fillimi i punës së fondit (18 tetor 2022)

Që nga fillimi i punës së fondeve vullnetare pensionale, shoqëritë pensionale SAVA dhe KB Prvo, tre herë e kanë zvogëluar kompensimin nga kontributet. Kompensimi i mjeteve që nga fillimi i punës së shtyllës së tretë ishte 0,15% në muaj e vlerës së neto-mjeteve të fondit vullnetar pensional. Gjithashtu, në vitin 2011, të dyja shoqëritë e zvogëluan edhe kompensimin e mjeteve në 0,100% në SAVA dhe në 0,075% në KB Prvo. Në vitin 2021, SAVA edhe një herë e zvogëloi kompensimin e mjeteve dhe tani ai është 0,075%.

Arkëtimi i kompensimeve (në mijë denarë), nga shoqëritë që i menaxhojnë fondet vullnetare pensionale, gjatë vitit 2024, sipas muajve dhe sipas llojit të kompensimit, është dhënë në Tabelën 6.9.

Provizionet e transaksioneve, në lidhje me transaksionet për blerjen ose transferimin e aseteve të fondit vullnetar të pensioneve, paguhet nga asetet e fondit vullnetar të pensioneve dhe mblidhen nga subjekte të zgjedhura juridike që ofrojnë shërbime me letra me vlerë, si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Tarifat e transaksioneve llogariten si përqindje e vlerës së secilit transaksion të përfunduar.

Gjatë vitit 2024, nga SAVAv u mbledhën gjithsej afërsisht 314 mijë denarë provizione transaksionesh, nga KBPv u mbledhën gjithsej afërsisht 157 mijë denarë, nga TRIGLAVv u mbledhën gjithsej 2 mijë denarë, ndërsa nga VFP u mbledhën 61 mijë denarë provizione transaksionesh.

Tabela 6.9. Arkëtimi i kompensimeve nga shoqëritë, në vitin 2024

(në milionë denarë)

	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shat.	Tet.	Nen.	Dhjet.	Totali
SAVAv – gjithsej	1.708	1.682	1.892	1.836	1.864	1.772	1.975	1.809	1.813	1.944	1.995	2.515	22.805
Nga kontributet	376	318	508	437	442	330	512	339	338	437	467	944	5.446
Nga fondet	1.332	1.364	1.384	1.400	1.423	1.442	1.463	1.470	1.476	1.507	1.528	1.571	17.359
KBPv – totali	1.570	1.704	1.675	1.758	1.793	1.988	1.680	1.819	1.763	1.855	2.485	3.053	23.142
Nga kontributet	259	369	324	402	420	597	280	418	346	412	1.005	1.530	6.363
Nga fondet	1.311	1.334	1.351	1.356	1.372	1.391	1.400	1.401	1.417	1.443	1.480	1.523	16.778
TRIGLAVv – gjithsej	13	13	13	18	14	19	16	16	26	23	37	30	237
Nga kontributet	5	4	5	9	5	10	7	6	13	9	23	15	110
Nga fondet	8	8	8	9	9	9	10	10	13	14	14	15	127
VFPv – gjithsej	64	86	86	110	102	296	169	117	138	158	160	307	1.792
Nga kontributet	9	25	22	39	28	213	69	16	30	47	45	187	730
Nga fondet	55	61	65	71	74	83	100	101	108	111	115	120	1.062

³¹ Nga 1 maji 2021 (paraprakisht ishte 2,90%).³² Nga 1 qershori 2023 (paraprakisht ishte 2,90%). %).³³ Nga 1 maji 2021 (paraprakisht ishte 0,100%).³⁴ Nga 1 janari 2011 (paraprakisht ishte 0,15%).

6.8 Pagesa e kompensimeve pensionale nga sigurimi vullnetar pensional me financim kapital

Kushtet për fitimin e së drejtës së kompensimit pensional dhe mënyra e pagesës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë janë më liberale në krahasim me shtyllën e dytë, por duhet pasur parasysh se ato janë kursime për periudhën pas daljes në pension. Pra, fondet mund të tërhiqen vetëm dhjetë vjet para moshës për fitimin e së drejtës për pensionin e pleqërisë, në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, që për momentin do të nënkuptonte brenda moshës 54 vjeçare për burrat dhe moshës 52 vjeçare për gratë. Gjithashtu, fondet mund të tërhiqen në rast kur tek anëtarit konstatohet paaftësia e përgjithshme për punë, nga Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë për Punë, pranë Fondit të SPIMV-së, pavarësisht moshës. Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit vullnetar pensional, fondet nga llogaria e anëtarit bëhen pjesë e masës së trashëgimisë dhe me to vepron në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë.

Fondet nga shtylla e tretë përdoren sipas dëshirës së anëtarit në llojet e kompensimeve pensionale si në vijim:

- pagesë e njëhershme ose e shumëhershme e fondeve;
- anuiteti pensional i paguar nga shoqëria e sigurimit e autorizuar për këtë qëllim;
- tërheqjet e programuara të paguara nga shoqëria që menaxhon fondin vullnetar pensional, ose
- kombinimi i opsioneve të lartpërmendura.

Sigurimi i pensioneve dhe kompensimeve pensionale, të cilat paguhen nga shtylla e dytë dhe e tretë, rregullohet me Ligjin për Pagesën e Pensioneve dhe Kompensimeve Pensionale nga Sigurimi Pensional me Financim Kapital.


Në vitin 2024 janë realizuar 332 kompensime dhe pagesa pensionale nga shtylla e tretë. Pjesa më e madhe e kompensimeve pensionale të realizuara ishin në rastet e përmbushjes së kriterëve të moshës, pjesa më e madhe si pagesa të njëhershme, ndërsa një pjesë e vogël edhe si pagesa të shumëhershme. Një pjesë e vogël e pagesave në shtyllën e tretë ishin në rastin e vdekjes së anëtarit, me pagesën e trashëgimisë. Pasqyra e detajuar e kompensimeve pensionale të realizuara dhe pagesave për anëtarët e shtyllës së tretë, sipas fondeve vullnetare pensionale dhe llojit të llogarisë për vitin 2024, janë dhënë në Tabelën 6.10

Tabela 6.10. Kompensimet dhe pagesat pensionale të realizuara për anëtarët e shtyllës së tretë

Lloji kompensimit pensional dhe pagesat/ Fondi Vullnetar Pensional	SAVAv		KBpv		TRIGLAVv		VFPv		Totali
	Llog Ind	Llog prof	Llog Ind	Llog prof	Llog. Ind.	Llog. prof.	Llog. Ind.	Llog. prof.	
Pleqëria - Pagesa e njehershme	56	98	87	56	0	0	1	1	326
Pleqëria - Pagesat e shumëhershme	2	6	5	3	0	0	0	0	7
Trashëgimia	2	7	5	3	0	0	0	0	26

Në Grafikon 6.26. është paraqitur struktura e kompensimeve dhe pagesave të realizuara pensionale për anëtarët e shtyllës së tretë nga fillimi i punës së shtyllës së tretë, sipas viteve, përfundimisht në vitin 2023. Numri i pagesave është i vogël, sepse sistemi është ende i ri dhe anëtarët janë relativisht të rinj. Pjesa më e madhe e pagesave janë pagesa të njëhershme në rast të përmbushjes së kriterëve të moshës, pasuar nga pagesat në rastet e vdekjes së anëtarit si pagesë e trashëgimisë. Ekziston një numër i vogël pagesash të njëhershme në bazë të invaliditetit, si dhe pagesash të shumëhershme në bazë të përmbushjes së kriterëve të moshës.

Grafiku 6.26. Struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e tretë që nga fillimi i punës



7 Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale



7. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale

Që të mbrohen interesat e anëtarëve ekzistues, të ardhshëm dhe të pensionuar të financimit kapital të sigurimit pensional, si dhe që të sigurohet informim i drejtë dhe objektiv i publikut, marketingu zhvillohet në një mjedis të rregulluar, i cili është i përcaktuar me ligj dhe aktet nënligjore.

Gjatë vitit 2024, nuk u organizua provimi për agjentë për shkak se nuk u realizua prokurimi i përbashkët publik i institucioneve shtetërore për përzgjedhjen e personit juridik të autorizuar që e realizon teknikisht provimin.

Rritja e numrit mesatar të marrëveshjeve të lidhura për çdo agent vazhdoi, dhe kjo kryesisht për shkak të rritjes së numrit mesatar të marrëveshjeve të lidhura për çdo agent të TRIGLLAV. Në vitin 2024, numri mesatar i marrëveshjeve të bëra për agent mbetet është pothuajse në të njëjtin nivel si në vitin 2023. Kurse, numri i agentëve që kanë lidhur marrëveshje në vitin 2024 mbetet në të njëjtin nivel si viti paraprak të SAVA, ndërsa të KB e Para dhe TRIGLLAV ka një ulje.

Për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve ekzistues dhe të ardhshëm të anëtarëve në pension të sigurimit pensional me financim kapital dhe për t'i ofruar informim të drejtë dhe objektiv publikut, marketingu kryhet në mjedis të rregulluar, të normatizuar me ligj dhe me akte nënligjore.

Aktivitetet e marketingut janë të gjitha aktivitetet, qëllimi i të cilave është reklamimi i shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe informimi dhe lidhja e kontratave për anëtarësim në fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për pagesën e mjeteve nga fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Këto aktivitete përfshijnë: reklamimin e punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale që ato i menaxhojnë, informimin për karakteristikat e sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional me financim kapital, informimin për kompensimet dhe provizionet e transaksionit, informimin për kontributet e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, informimin për portofolet e investimeve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, informimin për llogaritë individuale, llogaritë vullnetare individuale dhe llogaritë profesionale, anëtarësimin dhe transferimin e anëtarëve nga njëri fond i detyrueshëm pensional në tjetrin, anëtarësimin dhe transferimin e anëtarëve nga njëri fond pensional vullnetar në tjetrin, lidhjen e kontratave për tërheqje të programuara, kontratave për pagesën e njëhershme dhe kontratave për pagesat e shumëhershme dhe aktivitete të tjera për qëllime reklamimi dhe sigurimi të informacioneve në lidhje me punën e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale. Shoqëria pensionale mund të kryejë veprimtari të marketingut në fondin pensional, në hapësirat e saj, në hapësirat e bashkëpunëtorëve të saj afaristë për marketing ose jashtë tyre, drejtpërdrejt ose nëpërmjet llojit përkatës të komunikimit (me telefon, faks, internet). Hapësirat e marketingut duhet të përmbushin kushte të përcaktuara me ligj.

Për t'i mundësuar MAPAS-it ta ushtrojë funksionin e kontrollimit mbi materialet e marketingut, shoqëria pensionale është e detyruar t'ia dorëzojë MAPAS-it, në fotokopje ose në mediumin e jashtëm përkatës, çdo material të publikuar për marketing, brenda tre ditëve pas publikimit të tij. Në rast kur MAPAS-i konsideron se ndonjë reklamë ose ndonjë material tjetër të shkruar mund të shkaktojë konfuzion, mund me aktvendim ta ndalojë publikimin ose shpërndarjen e mëtejshme dhe të urdhërojë publikimin e ndryshimit të atij materiali, brenda afatit që do ta përcaktojë vetë.

Personi që bën marketing, përkatësisht agjenti, mund të jetë person i punësuar në shoqërinë pensionale ose person tjetër i angazhuar me kontratë nga shoqëria pensionale. Agjenti mund të ushtrojë aktivitete të marketingut në fondet pensionale dhe/ose të lidhë kontratë të anëtarësimit ose të pagesës së mjeteve, vetëm për fondet pensionale të menaxhuara nga shoqëria pensionale në të cilën ai është i punësuar ose i angazhuar me kontratë. Agjenti detyrimisht është i pranishëm në lidhjen e kontratës së anëtarësimit në fondin pensional, të kontratës së transferimit, kontratës së tërheqjeve të programuara, kontratës së pagesës së njëhershme dhe kontratës me pagesat e shumëhershme dhe është i detyruar të nënshkruajë kontratën e tillë. Agjenti është i detyruar që të gjitha kontaktet me anëtarin, me anëtarin në pension ose me personat që kanë të drejtë të bëhen anëtarë dhe anëtarë në pension në fondin pensional, t'i bëjë personalisht dhe nuk guxon të lidhë kontratë nëpërmjet personit tjetër. Agjenti, gjithashtu, ka rol të rëndësishëm edhe në përzgjedhjen e llojit të pagesës së pensionit nga sigurimi pensional me financim kapital, nga anëtari, dhe është i detyruar që personalisht t'i paraqes ofertat për pensionet e projektuara të ardhshme të anëtarit që ka parashtruar kërkesë për kotacion, me shpjegimin e detajuar të karakteristikave dhe supozimeve të përdorura për të gjitha llojet e pagesave të pensioneve.

Personi mund të kryejë aktivitete të marketingut, vetëm pas regjistrimit të tij në Regjistrin e Agjentëve të mbajtur nga MAPAS-i. MAPAS-i e përcakton mënyrën dhe procedurën e dhënies së provimit për agjentë dhe mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të personit në Regjistrin e Agjentëve. Gjatë vitit 2024, nuk u organizua asnjë provim për agjentë për shkak të moszbatimit të prokurimit të përbashkët publik të institucioneve shtetërore për përzgjedhjen e personit juridik të autorizuar që zhvillon teknikisht provimin.


Gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithsej 37 agjentë, nga të cilët 29 agjentë në SAVA, 8 agjentë në TRIGLAV. Riregjistrimi³⁶ është bërë për një agjent të TRIGLAVIT. Gjithashtu është bërë rinovimi vjetor i regjistrimit³⁷ për një agjent në SAVA. Gjatë vitit 2023,

³⁶ Riregjistrimi i agjentit për një shoqëri pensionale bëhet për agjentin që më parë ka qenë agjent aktiv i shoqërisë tjetër pensionale.


³⁷ Nga dhjetori i vitit 2023, u shfuqizua detyrimi i shoqërisë pensionale për të rinovuar çdo vit regjistrimin e agjentëve

gjithsej 6 agjentëve iu është ndërprerë statusi i agjentit, nga të cilët 4 agjentë të SAVA-s dhe 2 agjentë të KB Prvo. Një pasqyrë e numrit dhe vlerave mesatare të statuseve të agjentëve të regjistruar, të rinovuar dhe të përfunduar nga viti 2019 deri në vitin 2024 për shoqëri pensionale është dhënë në Grafikon 7.1. Mund të theksohet se numri i agjentëve të regjistruar në të gjitha shoqëritë pensionale në vitin 2024 është shumë i vogël sepse në vitin 2024 nuk janë organizuar provimet për agjentë.

Grafiku 7.1. Numri i statuseve të regjistruara³⁸, të rinovuara dhe të ndërprera të agjentëve sipas viteve dhe shoqërive pensionale



Grafiku 7.2 Numri i agjentëve që kanë nënshkruar kontrata për anëtarësim në FDP dhe numri mesatar i kontratave për agjent



³⁸ Numri i agjentëve të cilët janë regjistruar përsëri përfshihen në numrin e agjentëve të regjistruar

Për sa i përket numrit të kontratave për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale, të cilat janë lidhur nga agjentët që nga fillimi i punës së sistemit, nga Grafiku 7.2. mund të vërehet se më së shumti agjentë, të cilët mesatarisht kanë lidhur më së shumti kontrata për anëtarësim, ka në vitin 2005, duke qenë se ky ishte fillimi i sistemit dhe deri më 31.12.2005, ishte afati i fundit që anëtarët vullnetarë të zgjidhnin nëse do t'i bashkoheshin sistemit me dy shtylla dhe të nënshkruajnë kontratë. Në vitet e ardhshme, numri i agjentëve që lidhin kontrata është në rënie të vazhdueshme nga viti në vit, dhe në të njëjtën kohë numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent është në rritje deri në vitin 2011. Më pas, deri në vitin 2014, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent ka rënë ndjeshëm. Në vitet e ardhshme, numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata dhe numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent mbeten përafërsisht në të njëjtin nivel. Në vitin 2019, kur filloi aktivitetin shoqëria e tretë pensionale, ka sërish rritje të numrit të agjentëve që kanë lidhur kontrata si dhe rritje minimale të numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent krahasuar me vitin 2018. Rritja e numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent vazhdon edhe në katër vitet e fundit më së shumti për shkak të rritjes së numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent në TRIGLAV. Sa i përket numrit të agjentëve që kanë lidhur kontrata në vitin 2023, ka një rritje të lehtë në SAVA dhe KB e Parë, dhe një rënie në TRIGLAV. Në vitin 2024, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent mbetet pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2023. Ndërkohë, numri i agjentëve që lidhën kontrata në vitin 2024 mbetet në të njëjtin nivel me vitin e kaluar edhe për agjentë që kanë lidhur kontrata në SAVA, ndërsa te KB Prvo dhe TRIGLAV ka një rënie.